

# Ndahet nga jeta "Doktor Flori", projektet e mbetura në mes të artistit rebel

Dyshohet se shkak i vdekjes ka qenë përdorimi i substancave narkotike. Homazhet në RTSH



# [SHQIPTARJA.com]

LEKË 30


VITI IV - NR. 272 - E MARTË - 18-11-2014

Lexoni Dëgjoni Shikoni  
EDICIONI MULTIMEDIAL



Kjo gazetë përdor teknologjinë QR-CODE

# NDERTIMET PA LEJE DERI NE TETE VJET BURG PER SHKELESIT



**Projektligji / Qeveria paraqit nismën për ndryshim në Kodin Penal. S'ka më gjoba, dënimi i vetëm burgimi. Ikën INUK vjen Inspektoriati për Mbrojtjen e Territorit**

▶ FAQE 2-3

## BALADË



NGA **ARBEN DUKA**

Dr. Flori, shpirt i madhirebelimit...

▶ Në faqen 20

bashkë me një satirë politike

## KOMENT



NGA **GJOKË DABA**

Pa njohur krimet, s'ka marrëdhënie normale

Themi me fjali më të plotë: Pa njohur Serbia krimet, dmth pa pranur qeveria serbe që shteti dhe kombi serb kanë bërë krime ndaj shqiptarëve, nuk mund të vendosën marrëdhënie normale midis shqiptarëve dhe serbëve. Pranimi i krimit nga ana e kriminelit ia ul hundën kriminelit, e çarmatos kriminelin nga veprimtaria e tij negative. Kjo është çështje metodike, me anën e së cilës hapen rrugët e zhvillimeve të mëtejshme. Kjo zbatohet ndaj secilit individ, i cili ka kryer krime.

▶ vijon në faqen 17

### KUVENDI

**Miratohet me 77 vota në parim buxheti dhe paketa fiskale**

▶ FAQE 4-5-6

### DOSJA E VRASESVE

**Ja VIP-at e Vlorës që janë deshmitarë në gjyqin e bandës**

▶ FAQE 12

### ÇLIRIMI I TIRANES

**Letra që dëshmon raportin midis Mehmet Shehut e Enver Hoxhës**

▶ FAQE 21



**Blue Medical Center**

Vizita, Analiza & Diagnostikim

Të garantuara sipas protokolleve të mjekësisë bashkëkohore nga Blue Medical Center

**Të parandalosh, më mirë se të kurosh!**

Adresa: Rruga "Bardhyl" Nr.101, Tiranë Tel: + 355 4 2370 668 Cel: +355 66 20 90 008 Email: info@bmc.al, www.bmc.al



Academy Australasia



American Training Center



ande-lm®

Ajencia ANDE-LM®, në bashkëpunim me "American Training Center", ka kënaqësinë të prezantojë për herë të parë në Shqipëri Kursin OET, të dhurur për Karrierë e Punësim në Fushën e Mjekësisë në Australi, Zelandë e Re, Singapor.

Kursi OET ofrohet nga Dekani i "Academy Australasia", i cili vjen nga Melbourne enkas për ju!

Kursi do zhvillohet në Tiranë në datat 03-14 Nëntor 2014 dhe 01-14 Dhjetor 2014, dhe kërkohet rezervimi paraprakisht duke kontaktuar në INFO@ANDE-LM.COM.AL ose 069 20 21 181.

Nëse doni të punoni në Australi, Zelandë e Re, Singapor në Mjekësi, OET është hallka e parë!



Agjencia ANDE-LM®, lider në punësimin jashtë-vendit që prej vitit 2004, sjell punëdhënës ekskluziv për në Lindjen e Mesme në vende të mirënjohura tashmë për të gjithë si Dubai, Doha, Kuvajt, Oman, Bahrein, etj për kontrata pune afatgjata në të gjitha profilet.

Kërkimë njerëz të interesuar të profileve ndërtim, hoteleri, kuzhinë, menaxhim, financë, inzhineri, mjekë, infermiere, kujdes ndaj fëmijëve, kopsharë, agent shitësh, fizioterapi, teknik kompjuterash, etj të aplikojnë duke kontaktuar në

INFO@ANDE-LM.COM.AL ose 069 20 21 181 menjëherë!

Partnerët ofrojnë punësim Urgjent dhe Mundësi Interviste të Menjëherëshme. Tarifa administrative është vetëm 350 Euro, dhe të gjitha kostot e tjera janë 0.

JU MIRËPRESIMI!

# » KODI PENAL

**SANKSIONET** Ashpërsohen masat në luftën kundër ndërtimeve pa leje; për të rritur efikasitetin e institucioneve, zaptimi i tokës së tjetrit dënohet shumë rëndë

# Ndërtimet pa leje, s'ka më gjoba, deri tetë vjet shkelësve

## Qeveria paraqit nismën për ndryshim të Kodit Penal

**GENC KONDI**  
TIRANE

Qeveria propozon heqjen e dënimit me gjobë për ato që ndërtojnë pa leje. Në rast se miratohet ndryshimet e propozuara me një projektligj të posaçëm në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, dënimi i vetëm do të jetë burgimi, që fillon nga një, për të arritur

**Gjykimi**  
Kodi Penal parashikon gjykim me gjyqtar të vetëm për shkeljet e sipërpërmendura. Propozimi i ri është që, kur vepra është e cilësuar, proceduralisht detyron gjykimin nga 3 gjyqtarë



deri në tetë vjet për shkelësit. Propozohet që të ndryshojë edhe neni 199/a i Kodit, "Ndërtim i paligjshëm", duke u riformular si vijon: "Ndërtimi apo punimi, i kryer pa leje, në shkelje të lejes ose në kushtet e një lejeje të shfuqizuar dhe në tokë të vet, dënohet me burgim deri në një vit. Po kjo veprë, e kryer për qëllime fitimi, në tokën publike ose shtetërore apo në tokën e tjetrit, dënohet me burgim nga dy deri në tetë vjet. Dispozitat

e këtij neni zbatohen sipas rastit edhe ndaj pronarit të ndërtimit, sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe zbatuesit të punimeve". Sipas qeverisë, të tilla ndryshime motivohen nga domosdoshmëria e ndërhyrjes edhe në nivel të legjislacionit penal, në kushtet e përballes me një situatë alarmante ndërtimesh pa leje në territor, situatë e cila cenon haptazi zhvillimin e territorit. Parashikimi aktual për sanksionet ndaj shkelësve, sipas hartuesve të projektligjit, është i mangët në raport me shfaqjet konkrete të kësaj veprë, sepse, ndërsa penalizohen ndërtimet pa leje, nuk rezultojnë që të penalizohen dhe punimet, dhe fjala është për ato lloj punimesh, për të cilat kërkohet të merret leje paraprakisht.




### Politika

TIRANE

Ndryshimi i propozuar në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë do të ofrojë një rast tjetër për të testuar qmëbshtetjen e koalicionit qeverisës në deputetë të grupeve jashtë mazhorancës. Kjo, pasi amendimet në Kode kërkojnë shumicë të cilësuar, pra të paktën 84 vota. Një shumicë e tillë tashmë është arritur, madje edhe është tejkaluar në raste të mëparshme. Gjithsesi, kjo do të jetë edhe një provë për politikën e "dorës së fortë" të Ramës, në përpjekje për të vendosur ligjin dhe rendin në mbarë vendin, ndërkohë që nuk përjashtohen zëra nga grupet brenda apo pranë mazhorancës që mund të kërkojnë votë kundër, të nxjerr nga interesa elektorale.

Në fakt, gjatë këtij viti, ka patur më shumë se një rast, kur, pavarësisht nga vërejtjet dhe përplasjet, është arritur të sigurohet shumica e cilësuar. Në seancën e fundit parlamentare për sesionin e verës, Kuvendi miratoi me shumicë të cilësuar votash disa projektligje që lidhen me reformën në drejtësi. Kështu me 84 votat e mazhorancës Kuvendi miratoi shtesa në Kodin Penal; po ashtu me 84 vota u miratuan dhe disa shtesa e ndryshime në Kodin e Procedurës Penale. Me 84 vota u votuan dhe ndryshimet në ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative", si dhe shtesat në



Faksimile e projektligjit për ashpërsimin e luftës kundër ndërtimeve pa leje

# Ndryshimet në Kode kërkojnë 84 vota deputetësh në Kuvend

Shumica më e lartë në Parlament është arritur me 89 vota pro

ligjin "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë". Ndërkaq, Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë, u miratua madje, me rezultat edhe më të thellë: me 89 vota. Këto pesë ligje

ishin mbartur nga seanca e mëparshme për shkak të mungesës së kuorumit prej 84 votash, i domosdoshëm për miratimin e tyre, pasi veç opozitës, mungonin disa nga deputetët e mazhorancës.

Ndërkohë, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar me 88 vota pro, 1 kundër dhe 1 abstenim, edhe reformën administrative-territoriale, për hartën e re me 61 bashki, që u shënuan si arritja më e madhe politike e këtij viti.



### Dënimi

Parashikimi aktual për sanksionet ndaj shkelësve, sipas hartuesve të projektligjit, është i mangët në raport me shfaqjet konkrete, sepse penalizon ndërtimet pa leje, por jo dhe punimet

### OBJEKT FITIMPRURËS

Në Kodin Penal, krahas rrethanave të tilla si tokë publike ose shtetërore apo e tjetrit, shtohet një rrethanë tjetër që e rëndon dënimin, ajo e ndërtimit për qëllime fitimi. Sipas relacionit përcjellës të p/ligjit, ndërtimet për qëllime fitimi kanë vOLUME shumë më të mëdha dhe, rrjedhimisht, dhe dëmi që sjellin në territor, në mjedis po ashtu, është i tillë dhe në shumicën e rasteve dhe i pakthyeshëm. Dispozita ekzistuese i parashikon të dyja llojet e dënimeve kryesore, si dënimin me gjobë dhe atë me burg, me një maksimale dënimi që shkon përkatësisht 1 vit burgim dhe 5 vjet burgim. Të tilla masa dënimi nuk kanë shërbyer aspak për të ndaluar ndërtimet e paligjshme që kanë pushtuar gjithë territorin, nga veriu në jug, një arsye e mjaftueshme kjo për të kuptuar se duhet ashpërsuar masa dhe lloji i dënimit në mënyrë që dispozita të mund të sjellë efekt. Propozimi i qeverisë është që dënimi për këtë veprë penale në çdo rast të jetë vetëm me burg, duke hequr mundësinë e aplikimit të një dënimi me gjobë. Veç kësaj, në rastin kur vepra parashikohet si e cilësuar, pra kryhet për qëllime fitimi, në tokën publike ose shtetërore apo në tokën e tjetrit, propozohet një masë dënimi e tillë që të realizojë plotësisht efektin ndëshkues dhe parandalues.

**ABUZIMET**

### Konkurrenca heton tenderat e Unazës së Re

— Autoriteti i Konkurrencës ka hapur hetime për një kartel të mundshëm gjatë prokurimit për ndërtimin e Unazës së Jashtme Tiranë, pjesa verilindore (segmenti Kthesa e Saukut – Bregu i Lumit) loti 1, loti 2 dhe loti 3. Nga informacionet paraprake, vihet re se vlera e ofertave fituese në të tre lotet e procedurës së prokurimit është mbi 99% të fondit limit, operatorë ofertues janë vetëm tre ndërmarje dhe fituese të loteve janë sejcila prej ndërmarrjeve pjesëmarrëse, duke krijuar një skemë rotacioni për shoqëri-në që do të shpallej fituese. Afërsia e ofertës fituese në raport me fondin limit është shenjë bashkëpunimi mes kompanive.





## Gjikhuri: Gati heqja e licensës për 30 subjekte minerare

Kanë mosplotësim të pagesave garanci për mjedisin

### Industria

TIRANE

Ministria e Energjisë dhe Industrisë njoftoi dje se ka nisur procedurën e revokimit për 30 leje të tjera të subjekteve që operojnë në fushën e minerave. Gjatë kontrollit të ushtruar nga strukturat e Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë është konstatuar se këto subjekte kanë mospërbushje të detyrimeve ligjore, kryesisht për mospagesë të garancive financiare të mjedisit. Sa më poshtë vijojnë emrat e subjekteve, që po kalojnë

“në sitë”. Subjekti “Mu-Leu”, “Tirana Inert & Konstruksion”, “Mineral-Invest”, “Bledi”, “AG Cahani”, “Roirmar”, “Ismaili”, “Mineral Invest”, “Ylberi”, “Prendi 02”, “Prodhime Karbonike”, “Neza”, “Margariti”, “Madridi-I”, “Kanina I”, “Imperial Construcion Plus”, “Ardmir”, “Co.Be.In”, “Zotaj-Z”, “Aj-Fd”, “Emiliano”, “Euro Inert Biba”, “Zhopi”, “Xhindi”, “Union Idea”, “Simaku”, “General Cement Albania” (dy leje), “Tirana konstruksion” dhe “Malvini”.

Ndërkohë, janë miratuar prej Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë dhe përcjellë për dhënie leje zhvillimore komplekse një sërë objekteve të natyrës energetike e industriale, si për ndërtimin e linjës së transmetimit të energjisë elektrike 110 kV,

**Lejet**  
Ministria njofton se për vitin 2014 janë shqyrtuar gjashtë procedurë për dhënie leje zhvillimore të subjekteve për ndërtimin e HEC-eve, të cilat janë dërguar për miratim në agjencitë përkatëse



Ersekë-Përmet, për ndërtimin e centralit elektrik fotovoltaik nga shoqëria ujësjellës kanalizime Korçë Sh.a, me fuqi të instaluar 1 Më, ndërtimi i parkut eolik në Snyej-

Kavajë, ndërtimi i Uzinës së Pasurimit të Ferrokromit në Elbasan e Bulqizë dhe ndërtimi i impiantit të pasurimit të Rërave Bituminoze në Patos-Marinëz.

### Projektligji



GENC KONDI  
TIRANE

## Ikën INUK, vjen Inspektoriati për Mbrojtjen e Territorit

Vendorët s'marrin masa penale, kompetencat i merr IKMT

Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, që do të zëvendësojë INUK-un, do të marrë në zonat apo objektet me rëndësi kombëtare kompetencat e deritanishme të inspektoriave të pushtetit vendor në to, duke i përfshirë nga fusha e përgjegjësisë. Kjo është bazuar në faktin se lejet e ndërtimit në këto zona jepen nga KKT-ja dhe jo nga kryetarët e njësisë vendore. Ky është thelbi i një projektligji, që ka mbërritur në Kuvend, pasi është miratuar në Këshilli i Ministrave. Me anë të këtij akti ligjor, synohet sigurimi i ndërhyrjes së menjëherëshme dhe të pakufizuar të IKMT-së në zonat apo objektet me rëndësi kombëtare dhe në territor, duke dhënë një përkufizim të saktë të këtyre të fundit për të mos lënë vend për interpretime evazive, si dhe duke hequr pengesat ndaj ndërhyrjes së IKMT-së në këto zona që parashikonte ligji i mëparshëm.

### ARSYETIMI

Sipas të dhënave të njësisë vendore, rezultojnë se në rastet kur janë konstatuar ndërtime pa leje, masat e marra nga inspektoratet vendore nuk kanë qenë në përputhje me situatën konkrete. Në

**Problemet**  
Bazuar në ligjin ekzistues, masat parandaluese dhe ndëshkuese në drejtim të sigurisë dhe mbrojtjes së territorit nuk kanë ndikuar aspak në rritjen e performancës së inspektorateve vendore



shkallë vendi rezultojnë të jetë depozituar një numër i papërfillshëm kallëzimesh penale në raport me numrin

konstatimi për ndërtime pa leje, lidhur me të cilat nuk jepet asnjë informacion për numrin e kallëzimeve penale

### PENALIZIMET

**Policia në tetor 2013-15 shtator 2014 ka kallzuar 1.491 raste ndërtimesh pa leje, me 1.496 autorë; 42 janë arrestuar në flagrancë, 18 janë në kërkim, 1.436 ndiqen në gjendje të lirë**

e ndërtimeve pa leje. Kështu, për periudhën 2009-2014 në bashkinë e Tiranës janë mbajtur 5823 procesverbale

të depozituara. Në bashkinë e Durrësit janë konstatuar 722 ndërtime pa leje, për të cilat janë paraqitur vetëm 12

kallëzime penale. Në bashkinë e Vlorës janë konstatuar 376 ndërtime pa leje, për të cilat janë paraqitur vetëm 88 kallëzime penale, etj. Nga vlerësimi i ligjit ekzistues dhe efektivitetit të zbatimit të tij në veprimtarinë e Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar dhe atyre vendorë të njësisë vendore ka rezultuar se përgjegjësitë e inspektorateve vendore dhe atij kombëtar lënë hapësirë për keqinterpretim e moszbatimim. Në ligjin ekzistues është përcaktuar arsimi i mesëm për punonjësit e inspektorateve vendore, çka ka sjellë në këto vite që në përbërjen e inspektorateve vendore të punësohen njerëz me kapacitete të ulëta tekniko-profesionale, gjë që ka ndikuar pa dyshim në performancën tejet të dobët në punën e këtyre inspektorateve.

**Vendorët**  
Aktualisht ndërtohet në mënyrë të kundërligjshme në çdo komunë/bashki dhe rastet e ndalimit të tyre janë të papërfillshme, në krahasim me dëmin që i shkaktohet territorit

### MISIONI

**Mbërrijnë në Tiranë zyrtarët e FMN-së**

— Misioni i Fondit Monetar ka rihapur dje bisedimet që u lanë përgjysmë në shtator. Ato do të përqendrohen në buxhetin 2015 dhe realizimin e kriterave të performancës, që mundësojnë lëvrimin e kështit të prapambetur të kredisë së FMN-së dhe kështit të radhës, disburimi i të cilave pritet të bëhet brenda dhjetorit të këtij viti. Misioni nuk arriti marrëveshje me qeverinë shqiptare në shtator për transhin e tretë të huasë, prej 26 milionë eurosh.

## » BUXHETI

**KRYEMINISTRI** prezantoi dje draftin e buxhetit për vitin 2015 në Parlament, në mungesë të opozitës dhe deklaroi se pavarësisht kundërshtive qeveria do të heq aksizën për pijet energjike



**Dokle**  
Heqja e akcizës për pijet energjike është një gabim i madh. Kjo do të thotë që i hiqet buxheti një financim i tillë që do të ishte i mjaftueshëm për të rritur disbursimin për 70 mijë diabetikë apo për të çuar me studime 2 mijë studentë.

# Rama: Ulim dhe zerojmë taksat pa masa shtrënguese

## Qeveria rrit akcizën e cigares, heq atë për pijet energjike

**JUXHIN MUSTAFARAJ**  
TIRANE

**B**uxheti për vitin 2015 do të ketë në thelb rritjen ekonomike e cila ndryshe nga më parë nuk do të shoqërohet me masa shtrënguese. Ky ishte premtimi që kryeministri Edi Rama bëri dje gjatë paraqitjes që bëri në Parlament të draftit të buxhetit të shtetit për vitin 2015. Sipas kreut të qeverisë, buxheti është i bazuar në rekomandimet e bëra nga ndërkombëtarët dhe pritet që të përbush të gjitha pritshmëritë e qeverisë në fund të vitit të ardhshëm. "Është një buxhet me disa standarde të mirëpërcaktuara dhe me disa zgjidhje realiste për një situatë, ku potencialet janë padyshim të mjaftueshme për të arritur objektivin tonë minimal të një rritje ekonomike përtej 4% në fund të vitit të katërt të këtij mandati", tha Rama. Kryeministri nuk e quajti avantazh mungesën e opozitës në seancë, madje u shpreh me keqardhje që në votimin e dy prej ligjeve më të rëndësishme është ai për buxhetin dhe paketa



fiskale, të djathtët bëjnë opozitë në distancë me qeverinë. Megjithatë Rama i është përgjigjur akuzave të opozitës, të cilët kanë pretenduar se buxheti i ri është shoqëruar i gjithi me rritje taksash. "Ky është një buxhet që vjen si rezultat i reflektimit të një pakete të re fiskale, që ul ose zeron 15 taksa, ndërkohe që rrit vetëm tre. Është një Paketë Fiskale, që në kushtet e vendit tonë, na jep mundësi që të stimulojmë prodhimin që të stimulojmë përpunimin në vend", deklaroi kryeministri. Duke qartësuar të gjitha taksat që do të ndryshojnë në vitin 2015, kreu i qeverisë renditi një e nga një të taksave që do të ulen apo zeron dhe ato që do të rriten. Buxheti i vitit 2015 i rrit me rreth 49 miliardë lekë të ardhurat totale krahasuar me këtë vit, nga të cilat 16 miliardë vijnë nga rritja e taksave dhe pjesa tjetër nga rritja e ekonomisë dhe mirëadministrimi. Buxheti ul me 48 për qind deficitin buxhetor krahasuar me 2014, çka sipas Qeverisë bën të mundur që vitin tjetër borxhi publik të ul pas disa vitesh rritje. Mbështetje është parashikuar për shtresat në nevojë dhe rreth 5000 të mosuar që do të marrin pension social.

### TAKSAT QË ZEROHEN OSE HIQEN

- Sektori i sigurimeve hiqet TVSH-ja dhe zbatohet vetëm një taksë prej 3% mbi fitimin bruto.
- Ulet taksa doganore e naftës bruto, ose zerohet nga 10% në 0% që do të sjellë ulje të kostos së rafinerive.
- Ulje e rentës për kromin e përpunuar, është masë që do të stimulojë atë për të cilën prej vitesh Shqipëria ka nevojë.
- Ulje e taksës për gomat e reja që ka lidhje të shumëfishta duke filluar nga mbrojtja e mjedisit dhe sigurisë rrugore.
- Zerim të akcizës mbi bitumin natyral. Shqipëria edhe në këtë pasuri ka mjaft për të mund të marrë shumë më tepër se çka marrë. Përfshirjen nga tatimi mbi të ardhurat personale të kontributeve me fondet vullnetare të pensioneve që në momentin e kontributit.
- Rimbursim i TVSH-së dhe rivlerësim i mëtejshëm duke vendosur riskun si kriter në kontroll dhe duke hequr kontrollin e detyrueshëm.
- Rritje e rentës minerare për pushtetin vendor, duke hequr kufizimet në ligjin e buxhetit.
- Hiqet akciza për pijet energjike.
- Lehtësim i agro-përpunuesve duke njohur 20% TVSH të zbritshme për furnizime nga fermerët, nga 6% që ishte më parë.
- Përfshihen nga taksa e qarkullimit dhe karbonit për karburantet, sektori i peshkimit
- Subvencion i naftës për fermerët, me kushtin që fermerët të jenë pjesë e sistemit, të angazhimeve dhe të detyrimeve karshi buxhetit të shtetit.
- Për të gjitha lëndët e para, grurin, materialin biologjik, miellin, ushqimin për kafshët, kafshët për mbarështrim, hiqen tërësisht tarifat doganore.
- Përfshihen nga TVSH-ja në import mjetet dhe makineritë ushqimore. Gjithashtu përfshihen nga TVSH-ja në import kafshët e gjalla.

### TAKSAT QË RRIKEN

- Akciza për cigaret
- Taksa e qarkullimit mbi benzinën dhe gazolin
- Barazimi i tatimit mbi të ardhurat personale dytësore me tatimin mbi të ardhurat nga paga



### LETRA

# Nishani ankohet te Meta për uljen e fondeve me 3.4 për qind

"Nuk u dëgjuam, buxheti s'na mjafton për ceremonitë në vitin 2015"

**P**residenti Bujar Nishani është i pakënaqur me buxhetin që qeveria ka parashikuar për institucionin e Presidencës për vitin 2015. Shqetësimin e tij për këtë buxhet që parashikon një ulje me 3.4%, kreu i shtetit i'a ka përcjellë përmes një letre të hapur kryeparlamentarit Ilir Meta. Nishani në letrën e tij shpreh shqetësimin se asnjë prej përfaqësuesve të presidencës nuk u ftuan në seancat dëgjimore për buxhetin. Letra që i është drejtuar edhe krerëve të



grupeve parlamentare të PS, PD dhe LSI, shpreh shqetësimin se krahas shpenzimeve operative të presidencës, buxheti i ri ka parashikuar një ulje prej rreth 8.5% në krahasim me buxhetin e këtij viti. "Për vitin 2014, Institucionit të Presidentit të Republikës, megjithëse me ulje të theksuar krahasuar me dhjetë vitet e fundit, iu akorduan 183.2 milion lekë në total, ndërkohe që për vitin 2015 janë parashikuar 177 milion lekë, me një diferencë negative prej rreth 3.4% më pak. Po kështu për zërin shpenzime të

tjera operative në buxhetin e vitit 2015 është parashikuar ulje e këtij zëri me 8.5% më pak", deklaroi Nishani. Presidenti shprehet se ky buxhet nuk i lejon përbushjen e misionit kushtetues Kreut të Shtetit Shqiptar, pasi për vitin e ardhshëm janë parashikuar një sërë aktiviteteve me rëndësi kombëtare, si Samiti i Kryetarëve të Shteteve. Presidenti përmend edhe ceremoninë e 25 vjetorit të rënies së komunizmit për vitin 2015, si një event që kërkon mundësi financiare që nuk mund të mbulohej me këtë buxhet.

### Pagesat

Kryeministri Rama deklaroi se të ardhurat nga pagesat e energjisë elektrike janë surprizuese dhe premtosi se nëse do të vazhdohej me këto ritme, brenda dy vitesh energjia do gjenerojë të ardhura të larta.

### SHITJE ME ANKANDIN E PARË NGA STUDIO PËRMBARIMORE L.D.C

Pershkrimi i pasurisë:

1. "Apartament", me Nr. Pasurie 5/4+5-26/1, e ndodhur në Zonën Kadastrale Nr. 8270, regjistruar në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, e ndodhur në adresën Rr. "Muhamet Gjollështa", Pll. 17, Shk. 5, Kati 1, Ap. 26, Tiranë, vol. 18, faqe 43, me siperfaqe 31.80 m<sup>2</sup>.

Data e shpalljes **06.11.2014**  
Data e zhvillimit **20.11.2014 deri në orën 16.00**

Ankandi zhvillohet në ambientet e zyrës Studio Përmbartimore L.D.C të ndodhur në adresën: Rruga "Myslym Shyri", Vila 8, Kati 1, Tiranë, e-mail leter.canaj@yahoo.com



## Ndoka

## Me këtë buxhet shqiptarët do thonë "Thanas shtrëngo rripin"

— Opozitari i vetëm në parlament Nard Ndoka e konsideroi paketën fiskale dhe miratimin e buxhetit si një goditje për biznesin dhe qytetarët. Gjatë fjalës së tij në Parlament, Ndoka u shpreh se rritjet përbëjnë një rast flagrant të ikjes nga taksimi i ndershëm. "Ulen investimet për shëndetësinë. Rrisni numrin e policëve, por ulni investimet në policinë e shtetit. Ulni investimet në Fondin Shqiptar të Zhvillimit. Të gjitha këto masa shtrënguese dhe masa të tjera që do të futen gjatë rrugës, të krijojnë besimin se shqiptarët do ta presin vitin tjetër me sloganin 'Thanas shtrëngo rripin', deklaroi deputeti i PDK-së, Nard Ndoka.

## Votimi



JUXHIN MUSTAFARAJ  
TIRANE

**M**azhoranca e vetme ka kaluar në parim me 77 vota pro projektbuxhetin dhe paketën fiskale për vitin 2015. Në një seancë maratonë, deputetët e mazhorancës kanë mbështetur draftin e propozuar nga qeveria. Sot do të jetë Komisioni i Ligjeve që do të marrë në shqyrtim nen për nen buxhetin e ri i cili do të votohet më pas në seancën e ardhshme. Por edhe pse vendet e opozitës ishin bosh debatet në seancën maratonë nuk kanë munguar. Deputeti Pandeli Majko ka bërë opozitë për buxhetin përballë qeverisë, duke shprehur rezervat mbi rritjen e disa taksave. Majko ka shprehur rezervat e tij për rritjen e akcizës së cigareve duke theksuar se ky hap nuk po bëhet për të ruajtur shëndetin e familjarëve por për të mbushur gropat që ka në buxhet. "Nuk mendoj se shqiptarëve do t'u shëndoshet familja duke lënë duhanin. Ndër faktorët që sot janë prishës të familjeve, pijet alkoolike janë një faktor i rëndësishëm. Apo jo, zoti Beqja? Por në programin që na keni sjellë nuk ka ndonjë taksë për to", deklaroi Majko. Deputeti socialist ka përfaqësuar edhe banorët e zonës së tij elektorale, ku duke veçuar një familje ka kërkuar nga kryeministri të heq kamatvonesat e energjisë elektrike për shtresat në nevojë. "Ne sot votojmë faljen e kamatvonesave për pensionet në fshat. Çna gjeti të falim edhe kamatvonesat e atyre që janë në sistemin e mbrojtjes sociale për faturat e energjisë? Unë nuk besoj se kjo na shmang ndonjë faturë të kripur financiare. Përkun-

# Mazhoranca kalon në parim projektbuxhetin dhe paketën fiskale

Mungon opozita. Majko replika me Ramën për taksat e reja dhe kamatvonesat



## Shkëlqim Cani

Ministri i Financave Shkëlqim Cani ka evidentuar 5 pika të forta të buxhetit. Buxheti 2015 parashikon një kapërcim të ardhurave në raport me prodhimin e përgjithshëm bruto në 27.5%, nga 26% që është prishmëria për vitin 2014. Shpenzimet buxhetore do të rriten lehtë, nga 31.2% e PBB-së në 2014-n në 31.5% vitin e ardhshëm. Rritja e lartë e të ardhurave do u mundësojë financave të ulin deficitin buxhetor në 4% të PBB-së, nga 5.2% që pritet të mbyllet viti aktual. Ndrekohe që edhe borxhi publik pritet të zbrese në 70.6%, duke pësuar një rënie të lehtë. Vitin e ardhshëm ekonomia pritet të rritet me 3%.



Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të AIREPORT që shkarkohet falas



## Brace

Brace ka kundërshtuar heqjen e taksës doganore për importin e miellit dhe heqjen akcizës për pijet energjike dhe i kërkoi qeverisë hetim në tregun e karburantëve dhe prishjen e 4 kontratave koncesionare që rëndojnë mbi biznesin.

## NIKO PELESHI

"Buxheti i 2015, buxhet i reformave të guximshme"



12 orë u votua me 77 vota edhe projektligji, për faljen e kamatvonesave dhe gjobave për kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore, të papaguara nga personat e vetëpunësuar në bujqësi. Kuvendi votoi edhe projektligjet për "Tatimin mbi të ardhurat", "Taksat Kombëtare", "Akcizat në RSH".

drazi, na bën më të ndjeshëm ndaj personave në nevojë", u shpreh Majko. Por propozimi i ish-kryeministrit nuk është pritur aspak mirë nga kreu i qeverisë Rama i cili theksoi se nuk do të ketë asnjë tolerim për askënd që nuk paguan energjinë. "Ne nuk do falim asnjë kamatvonesë dhe askënd që nuk paguan energjinë. Kjo është një temë që për ne duhet të jetë tabu, me çdo çmim. Edhe me çmimin që njerëzit të thonë 'duam një qeveri tjetër sepse duam energji elektrike'. Le ta zgjedhin një qeveri tjetër, sepse ne nuk jemi zgjedhur për këtë", tha Rama. Ndërkohë gjatë seancës së djeshme që zgjati për më shumë se

## REAGIMI



## Buxheti katastrofal, qeveria po hap burgje dhe po mbyll shkolla

— Ish-kryeministri Sali Berisha e ka kundërshtuar Buxhetin e vitit 2015, që u votua dje në Kuvend pa praninë e opozitës. Njëpërmjet një postimi në "facebook", Berisha e ka konsideruar Buxhetin e ri si katastrofal, që rrit me 30% shpenzimet e qeverisë dhe të policisë. "Buxheti i ri është në funksion jo të qytetarit, as të fëmijëve, shëndetit apo shkollimit të tyre, por të shtetit policor, kontrollit policor të shoqërisë ku në vend që të hap shkolla po hap burgje", deklaroi Berisha.

## STUDIO PËRMBARIMORE "SPEED SOLUTION" NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT I

PËR:

"Apartament", me sip 131 m2, me nr.pasurie 4/145, volum 44, faqe 87, Z.k.8270, me adresë Rr."Perlat Rexhepi", kati 8, ap.42, TIRANË. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të ALPHA BANK ALBANIA sh.a. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **104 800 (njëqind e katër mijë e tetëqind) Euro**.

"Garazhd" me Sip.28 m2, volum 58, faqe 77, Z.k 8270, me regjister Hipotekor Nr.161 dt.18.03.2002 me adresë Rr."Perlat Rexhepi", kati 8, ap.42, TIRANË. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të ALPHA BANK ALBANIA sh.a. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **9 600 (nëntë mijë e gjashtëqind) Euro**

Ankandi do të zhvillohet më datë **01.12.2014, Ora 16:00**, pranë Studios Përmbarrimore "SPEED SOLUTION" me Adresë: Bulevardi "Gjergj FISHTA" Kulla. 1, Kati, 2. Nr.3, Tiranë.

Për çdo informacion mund të kontaktoni:  
cel. 0693041355, 0696334695 email: speed.solution@yahoo.com

— Zv/kryeministri Niko Peleshi e ka cilësuar buxhetin për vitin 2015 si një buxhet për reforma të guximshme. Peleshi bëri ironi me opozitën, duke kujtuar skenarët grek të saj, por sipas tij asnjë nga paralamërimet e opozitës nuk rezultoi i vërtetë. "Jemi në politikë për t'i dhënë vendit tonë dhe qytetarëve një jetë më të mirë. Opozita duhet të ishte edhe për të përballur faktin se askush nga paralamërimet e bëra si sot një vit më parë nuk rezultuan të vërteta. Është folur për skenar grek, për taksat që do u merrnin frymën bizneseve", u shpreh Peleshi.



**MINISTRJA** e Mbrojtjes Mimi Kodheli tha se do të hapet një qendër rehabilitimi për fëmijët autikë të ushtarakë me rreth 10 milionë lekë

**KODHELI** tha se do fillojë procesi i dhënies së kredive të buta për ushtarakët me probleme strehimi si dhe legalizimi i mjediseve ku ushtaraket jetojnë prej dy dekadash

**Edmond Haxhinasto**  
“Investime me vlerë 21.8 mld lekë në akset kryesore”

— Ministri i Transportit dhe Infrastruktura e konsideroi mjaft pozitivisht buxhetin e vitit 2015 dhe investimet e parashikuara. Ai tha se ka objektivat ambiciozë në lidhje me ujësjellës—kanalizime, ndër-kohë që përmes planit të investimeve që është rreth 21.8 miliardë Lekë, priten investime në disa akse kryesore si Milot-Lezhë, Rrugën e Kombit, aksin Plepa-Rrogzhinë, akset turistikë të bregut të Jonit, aksin e liqenit të Pogradecit, rrugët turistike të Alpeve, unazën e re të Tiranës, rrugën Lushnje-Berat, Buzuq-Çorovode dhe të tjera. Haxhinasto nënvizoi se krahasuar me këtë vit ka një rritje prej rreth 2.76% të buxhetit të vitit të ardhshëm për Ministrinë e Transportit. “Buxheti i ri do të mbështesë filozofinë tonë për më shumë siguri dhe cilësi. Buxheti do të mbështesë sektorin e transportit për një shërbim më të mirë. Peshën më të madhe të investimeve e zë Ministria e Transportit. Krahasuar me buxhetin fillestar të vitit 2014 kemi një rritje prej 2.76% më shumë. Së pari kjo do të na ndihmojë për afrimin e legjislacionit të transportit me atë të BE-së. Sa i përket mirëmbajtjes së rrugës, do të realizojmë një projekt shumë të rëndësishëm që shkon në 17 miliardë dollarë”, u shpreh ministri.



# USHTRIA / STREHIMI Kodheli: Kredi të buta për ushtarakët e legalizim banese

Ministrja: Do identifikojmë prona e troje për banesa. Qendër për fëmijët e tyre autikë

JUXHIN MUSTAFARAJ  
TIRANE

**M**inistrja e Mbrojtjes, Mimi Kodheli, ka thënë se ministria e saj do të vërë në dispozicion kredi të buta për ushtarakët e pastrehë. Teksa ka folur në Kuvend ku diskutohet buxheti për vitin e ardhshëm, ajo ka premtuar edhe një qendër për fëmijët autikë të ushtarakëve. “Nga ana tjetër ne do të hapim dhe do të vemë në funksion dhe një qendër rehabilitimi për fëmijët autikë të ushtarakëve, që do parashikohet të kushtojë 10 milion lekë. Njehkohësisht do të fillojë procesi i dhënies së kredive të buta për ushtarakët me probleme strehimi si dhe legalizimi i mjediseve ku ushtaraket jetojnë prej dy dekadash. Përveç kreditimit me shuma të vogla nga burimet që kemi në dispozicion, po identifikohen prona që mund të kthehen në fond banese, ashtu siç po identifikojmë troje apo ndërtesa që në bashkëpunim me Entin Kombëtar të Banesave, me të cilin kemi hedhur hapa konkretë, të mund të zgjidhim përfundimisht problemin e strehimit, një detyrim ky që buron nga statusi i ushtarakut”, tha Kodheli



në Kuvend. Sipas saj, buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes do mbështetet dhe nga të ardhurat dytësore të gjeneruara nga strukturat e veta, të cilat do të përdoren vetëm për modernizimin e FA. “Kemi filluar një proces për identifikimin e materialeve të tepërta, armatimit, municionit e pajisjeve të tjera që janë jashtë përdorimit të Forcave të Armatosura me qëllim rifuturjen e tyre në qarkullim ekonomik dhe gjenerimin prej tyre të burimeve financiare të nevojshme. Nga ky operacion pritet të sigurohet një shumë prej 700-800 milion lekësh”, tha Kodheli. Buxheti i Mbrojtjes për 2015 është mbi 12 miliardë lekë; ai nuk është në përputhje me kërkesat e Ministrisë së Mbrojtjes, por ai do garantojë operacionalitetin, tha Kodheli. Shumat e parashikuara për paga dhe sigurime do t’i nënshtrohen një analize ekspertësh, me qëllim që të reduktohen shpenzimet për funksione inefficente apo inproduktive. Sipas saj, do synohet që të ekuivalenohen disa funksione me ministri të tjera, që janë trashëguar në gjendjen që janë sot. Do të ketë rritje të ndjeshme shpenzimesh, më shumë se 3-fishi i shpenzimeve të 2014, do jetë për operacionet në kuadër të NATO-s, sidomos në zonat e nxehta, ku është i nevojshëm kontributi i FA shqiptare.



**Koço Kokëdhima**  
“Shlyerja e borxhit ndaj biznesit, një detyrim”

— Deputeti Kokëdhima vlerësoi prashikimin e qeverisë për të shlyer borxhet ndaj biznesit. Sipas Kokëdhimës, kjo nisim është hapi i parë i duhur dhe i domosdoshëm për të garantuar rritjen ekonomike të vendit tonë. Kokëdhima u shpreh se nga rritja e taksave për qytetarët do të mund të paguajnë më shumë, por siç tha ai për të marrë shërbimet që deri më tani i kanë munguar vendit tonë. “Ky projektbuxhet nuk është perfekt por është i mundshëm. Parashikon rritje ekonomike, por jo të ja kalojë Gjermanisë. Qytetarët do të paguajnë më shumë për vitin 2015 por do të marrin më shumë shërbime. Do të paguajnë për të shlyer borxhet që u morën dhe u keqpërdorën në një masë të madhe por që duhen paguar. Sot ne kemi humbur në mënyrë substanciale pavarësinë për hartimin e buxhetit. Kjo lidhet me rritjen e ekonomisë, të eksporteve. Shumica e investimeve kushtëzohen nga punimet në vazhdim, që ndoqen qeveritë e mëparshme përmes koncesioneve”, deklaroi Kokëdhima. Deputeti socialist kërkoi që borxhi i marrë të përdoret për investime. “Shteti ynë merr borxhe të cilët duhet t’i shlyejnë brezat e ardhshëm. Por këto borxhe duhen investuar në funksion të qytetarëve, tha Kokëdhima.

# “Fondi për Byronë, tregues i luftës kundër korrupsionit”

Tahiri: Qeveria riktheu rendin, buxheti i 2015 mëshhtë 14.7% më i lartë

**M**inistri i Brendshëm, Saimir Tahiri e sheh si mjaft inkurajuese rritjen e buxhetit që qeveria ka bërë për policinë. Ai deklaroi se buxheti 2015 dëshmon vullnetin për luftën kundër krimin dhe garanton rezultatet. Tahiri theksoi se lufta kundër kriminalitetit më tepër se forcë është dije. Tahiri u shpreh se brenda buxhetit do të ketë një zë të veçantë për ngritjen e Byrosë, për të luftuar korrupsionin elitar. Ai shtoi se ngritja e Byrosë së Hetimit është shtylla kurizore për funksionimin e policisë. “Buxheti i vitit 2015



është 14.7% më shumë se viti 2014 në planin fillestar dhe ai përfshin rritjen e numrit të policisë me 1087 vetë, të cilët do të dalin përmes një sistemi të mirëfilltë arsimor”, deklaroi kreu i Ministrisë së Brendshme në seancën e diskutimit të projektbuxhetit. Ndërkohë, Tahiri nuk la pa përmendur arritjet e mirëadministrimit të policisë gjatë vitit të lëmë pas. Ai tha se gjatë vitit të kaluar qeveria e rriti me 25% pagat e policëve dhe mirëadminis-

**SHITJE ME ANKANDIN E PARE NGA STUDIO PERMBARIMORE L.D.C**

Pershkrimi i pasurisë:

1. "Trulli+Ndertesë" e ndodhur ne Zonen kadastrale 3965, Volum 5, Fage 8, me numer pasurie 234, me siperfaqe trualli 1.479 m2 (trjemeje e katerqind e shtatedhjetje e nente m2), nga kjo ndertesë me siperfaqe 540 m2 (peseqind e dyzete mije m2), Regjistruar ne Zyren Vendore Regjistrimit Pasurive Paluajtshme Elbasan, e ndodhur ne metalurgji, Elbasan. Cnimi per shitje eshte 17.808.000 Leke. Regjistruar ne emer te Arben Sotiraq KOTE.

2. "Apartment" i ndodhur ne Zonen Kadastrale Nr. 8521, me numer pasurie Nr. 7/29+1-6, me siperfaqe 100 m2, Regjistruar ne Zyren Vendore Regjistrimit Pasurive Paluajtshme Elbasan, e ndodhur ne lagjen Luigj Gurakuqi, Elbasan. Cnimi per shitje eshte 4.490.000 Leke.

Data e shpallimit 04.11.2014  
Data e zhvillimit 18.11.2014 deri ne oren 16.00

Ankandi zhvillohet ne ambientet e zyres Studio Permbarimore L.D.C te ndodhur ne adresen: Rruga "Myslym Shyri", Vila 8, Kati i, Tiranë, e-mail letter.canaj@yahoo.com

troji luftën kundër krimin të organizuar dhe korrupsionit. Tahiri përmendi dhe faktin se të gjitha këto u arritën edhe pse trashëguan policinë më të varfër në Europë, për nga infrastruktura, për nga daja dhe për nga numri i punonjësve të policisë. “Falë angazhimit të policisë u arritën rezultate të përshëndetura nga publiku dhe qytetarët. Kryeministri i 8 viteve të kaluara, e sfidoi policinë se janë fshehur vrasjet, unë vij këtu



e them se vrasjet janë ulur 22%. Pavarësisht llumit që ka derdhur, (Berisha) nuk ka dalë askund të thotë se cilën vrasje ka fshehur qeveria. Ato që SHQUP-i i quan vjedhje “maska” janë ulur e 50%”. Treguesit në luftën kundër korrupsionit janë 83% më shumë, në raport me të njëjtin periudhë”, tha Tahiri. Duke mbështetur deklaratat e kryeministrit Rama për një polici më të ultën në rajon në raport me popullsinë dhe më e pashkolluara në evropë, Tahiri premtoi se me shtimin e buxhetit do të kemi një polici të denjë dhe me standartet e kërkura.



## » PENSIONET

**REFORMA** parashikon se duke nisur nga janari, në Shqipëri do të ketë pensionistë që do të marrin edhe 30 mijë lekë të reja pension

# Skema, Veliaj: Bonus për ata që punojnë pas daljes në pension

## BB vlerëson reformën si ndër më të mirat në botë

SONILA ISAKU  
TIRANE

Duke nisur nga 1 janari në Shqipëri do të ketë pensionistë që do të marrin edhe 30 mijë lekë të reja pension. Eliminohet kështu për herë të parë, tavanin i kësaj pagese që ishte 24 mijë lekë deri më sot. Ministri i Mirëqenies Sociale Erion Veliaj, pas takimit me përfaqësues të Bankës Botërore deklaroi se përfitimet më të mëdha do të kenë ata persona që vazhdojnë të punojnë e derdhen kontribute edhe përtej moshës së pensionit.

**PENSIONI BONUS**  
Të gjithë ata që duan të

**Nga skema e re e pensioneve edhe shteti do të arrijë të kursejë deri në 30 milionë dollarë, që në vitin e parë të aplikimit**

punojnë edhe pas moshës së daljes në pension, do të mund të përfitojnë një bonus për çdo vit punë deri në 4%. Për herë të parë do të ketë edhe pensione mbi tavanin e përcaktuar më parë. "Tavanin për herë të parë nuk varet më nga sigurimet

shoqërore, po nga individit. Nëse dikush do të punojë 35 vjet do ta ketë atë. Pra, nuk është ligj që detyron njerëzit të dalë në pension. Nëse dikush dëshiron dhe përtej moshës të rrijë në pension, përkundrazi për çdo vit pas 65 vjeç për burrat, dhe 60 për gratë, ka një bonus akoma më të madh për vitet që vazhdon e punon për vitet pas pensionit. Ku është fabula? Fabula këtu është që të inkurajojmë një shoqëri që rri më shumë në punë, dhe më pak pushim. Kështu që për këdo që punën e ka pasion dhe do të punojë dhe pas viteve të pensionit, përkundrazi, merr një bonus më të madh rreth 4 për qind për çdo vit pensioni që është në punë", tha Erion Veliaj, Ministër i Mirëqenies Sociale.



e 2015", vijoi ministri. Këto deklarata Veliaj i bëri gjatë një vizite në Arkivin Qendror të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, ku ishin të pranishëm edhe përfaqësues të Bankës Botërore. Drejtori i Operacioneve i Bankës Botërore, z. John Roome, vuri theksin te fakti se Shqipëria është në rrugën e duhur sa i takon reformës

së pensioneve. "Reforma e pensioneve në Shqipëri është një ndër reformat më të mira në botë, që janë ndërmarret në fushën e pensioneve. Është tamam ajo që duhet për një vend, i cili po ecën drejt Bashkimit Evropian", deklaroi Roome gjatë vizitës në ambientet e Arkivës Qendrore të ISSH-së.

### KONTRIBUTET

Nga ana tjetër ministri Veliaj u ka bërë sërisht apel të gjithë fermerëve në zonat rurale, që të paguajnë detyrimet e prapambetura të sigurimeve nëse kanë, pasi kjo do të jetë amnistia e fundit. Ndërkohë që nga viti i ardhshëm pagesat e sigurimeve mund të bëhen edhe çdo tre muaj. "Ajo që ne bëjmë tani është që mund të bëjmë kështu çdo tre muaj. Do të thotë që nuk ka nevojë ti paguash me një dorë, po çdo tre muaj, nga një janari e tutje. Por deri në 31 dhjetor çdo gjë e prapambetur duhet paguar tani, është me çmime modeste, nëse paguhet vitin tjetër do të paguhet me çmimin

### Aktiviteti

## Departamenti i Italishtes në UT, 30 vjet themelim



— Departamenti i Italishtes në Universitetin e Tiranës ka shënuar 30 vjetorin e tij të krijimit. Konferenca "Gjuha Italiane në Shqipëri mes të shkruarës dhe të ardhmes", sollti në kujtesë pedagogët por edhe studentët e parë që iu përkushtuan gjuhës italiane vetëm prej atyre pak njohurive që kishin për qytetet e bukura si Venecia, Roma, Xhenova por edhe për artin Italian. Ambasadori Gaiani i pranishëm në këtë konferencë u shpreh se e vlerëson shumë faktin që në Shqipëri italishtja njihet në shkallë të gjerë. "Më bëhet qejfi të shoh sallën kaq plot pasi unë i kushtoj një rëndësi të veçantë italishtes. Duke qenë se të dy vendet tona kontribuojnë për një politikë dhe ekonomi të qëndrueshme, njohja e gjuhës italiane në masë në Shqipëri ka bërë që shumë biznese italiane të hapen këtu duke punësuar me qindra njerëz. Italishtja ka arritur të jetë si gjuha e dytë e preferuar në Shqipëri si dhe në botë vazhdon të jetë në vendin e katërt për shkak të interesit që ka." tha ambasadori i Italisë, Massimo Gaiani. Dekania e Fakultetit të Gjuhëve të huaja Klodeta Dibra, duke folur edhe si një nga studentet e para të italishtes i kujton me mjaft emocion vitet në të cilat la pasionin për mjekësinë që t'i përkushtohej një pasioni tjetër, atij të gjuhës italiane.

### LAJME shkurt

Varfëria dhe droga largon nxënësit nga shkolla

— Përdorimi i lëndëve narkotike dhe braktisja e shkollës për shkak të kushteve të vështira ekonomike, janë dy problemet kryesorë të cilat ndeshen sot të miturit. Të dhënat e raportit "Save the Children" tregojnë se 85% e nxënësve, veçanërisht djemtë, shtyen të përdorin substanca narkotike dhe duhan nga nevoja për t'u dukur dhe nga kureshtja. Ndikimi i shoqërisë dhe konfliktet në familje, janë gjithashtu disa nga shkaqet pse fëmijët i drejtohen këtyre veëve. Por dhe braktisja e shkollave, sidomos për arsye ekonomike, janë një tjetër problem që duhet të ketë vëmendje. Ër realizimin e këtij raporti janë angazhuar grupet e drejtuara nga fëmijët nga qendrat e "Save the Children", të cilët anketuan 450 fëmijë në 12 shkolla.

### Energjia, Nikolla: S'ka kthim mbropa

— Ministria e Arsimit dhe Sportit, Lindita Nikolla, teksa asistoi dje në inspektimet e OSHEE-së dhe Policisë së Shtetit kundër lidhjeve të paligjshme të energjisë elektrike në zonën e Unazës së Re, tha se kjo është një betejë që nuk do të ketë kthim mbropa. Duke inspektuar aksionin kundër vjedhjes së energjisë, ministria Nikolla ftoi qytetarët që të denoncojnë rastet abuzive. Ndërkohë sipas Drejtorit të OSHEE-së, Arben Seferi, aksioni do të përfundojë kur të jetë këputur çdo fije e lidhjes së energjisë elektrike në mënyrë të paligjshme.

### INUK prish 20 objekte te Fusha e Aviacionit

— Aksioni i INUK këtë javë është përqendruar në afërsi të Fushës së Aviacionit ku do të prishen 20 objekte, në rrugën kryesore dhe në brendësi të lagjeve. Aksionet e njëpasnjëshme të Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik kanë sjellë ndërgjegjësimin e pronarëve për objektet e paligjshme. Të lajmëruar disa ditë më parë nga inspektorët e INUK, pronarët e këtyre ndërtesave kanë preferuar të prishin vetë për të shpëtuar këtë mundin. Këto objekte të cilat do të sheshohen, kanë qenë kryesisht lokale e dyqane.

### STUDIO PËRMBARIMORE "SPEED SOLUTION" NJOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT I

PËR:

"Apartament", me sip 62 m2, me nr.pasurie 1/473+1-16, Z.k.1664, e regjistruar ne regjistrin hipotekor nr.185 datë 11.09.2008 me adresë Lagjja Punëtori, Fushe-Krujë. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të BANKA E TIRANËS sh.a. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **2,480,00 (dy milionë e katërqind e tetëdhjetë mijë) Lekë.**

"Apartament", me sip 62 m2, me nr.pasurie 1/473+1-15, Z.k.1664, e regjistruar ne regjistrin hipotekor Nr.184, datë 11.09.2008 me adresë Lagjja Punëtori, Fushe-Krujë. Kjo pasuri është hipotekuar në favor të BANKA E TIRANËS sh.a. Çmimi me të cilin fillon ankandi është **2,480,00 (dy milionë e katërqind e tetëdhjetë mijë) Lekë.**

Ankandi do të zhvillohet më datë **03.12.2014, Ora 16:00**, pranë Studios Përmbarimore "SPEED SOLUTION" me Adresë: Bulevardi "Gjergj FISHTA" Kulla. 1, Kati, 2. Nr.3, Tiranë.

Për çdo informacion mund të kontaktoni:

cel. 0693041355, 0696334695 email: speed.solution@yahoo.com

# Nderohet Sokol Olldashi në përvjetorin e parë të vdekjes

Patozi e Mima shkruajnë tekstin e këngës në kujtim të mikut të tyre Sokol Olldashi

Në ceremoninë përkujtimore të 1 vjetorit të ndarjes nga jeta Sokol Olldashi nderohet me titullin "Qytetar Nderi" I Durrësit dhe me një këngë të shkruar nga miqtë e tij Florian Mima e Astrit Patozi, Bashkia Durrësit ditën e djeshme i ka dhënë titullin

lin "Qytetar Nderi", në përvjetorin e parë të vdekjes Sokol Olldashit. Këshilli bashkiak Durrësit ka votuar në mënyrë unanime akordimin e këtij titulli për Olldashin. Lajmin për nderimin me këtë titull për Olldashin e ka publikuar në rrejtin social "Facebook", miku i ngushtë i tij Iglj Cara. Deputeti demokrat Cara, shpreh mirënjohjen e tij për të gjithë anëtarët e këshillit bashkiak që votuan unanimisht për këtë titull, dhe shkruan se Olldashi dha një kontribut të madh për qytetin e Durrësit për vetë faktin se fati e deshi që ai të rritej pikërisht në këtë qytet. "Koli e konsideronte veten çun Durrësi, sepse "fati" e solli që të rritej në Durrës, këtu janë miqtë e shokët e parë të tij, këtu nis kënga e kitara e tij, këtu nis angazhimi i tij në politikë, këtu ka miq të mirë e shokë besnikë.

Olldashi dha shume në jetën e qytetit tonë, gjeti forma e mjete për të bërë e për t'u mbajtur mend në shtëpitë e durrsakëve, ta kemi "qytetar nderi" është më e pakta që mund të bëjmë për të", shkruan deputeti demokrat, Iglj Cara. Ndërkohë që, deputetët demokrat Astrit Patozi dhe Florian Mima janë autorët e tekstit të këngës kushtuar Sokol Olldashit. Këngë e cila do të këndohet nga kantautori i njohur Aleksandër Gjoka me orkestrim të Shpëtim Saraçit. Kënga është bërë enkas për përvjetorin e Olldashit, ceremonia përkujtimore e cilit do mbahet më 20 nëntor në Rogner. Ceremonia në nderim të ish-ministrit të Transporteve, i cili ka dhënë kontribut për vitet të tëra në politikën shqiptare, është titulluar nga organizatorët "Me Sokolin".



Sokol Olldashi

**Nderimi**  
Këshilli bashkiak Durrësit ka votuar në mënyrë unanime akordimin e titullit "Qytetar Nderi" për Sokol Olldashin.

Ftesa e shpërndarë nga miqtë e Sokolit, në pjesën e parë të saj mban nënshkrimin e tij dhe nga ana tjetër është vendosur fotografia e tij me

nënshkrimin "Takohe mi të enjten, më 20 nëntor 2014, ora 18: 00, në sallën "Apollonia" në Hotel Rogner. Miqtë e Sokol Olldashit.

## Buxheti ERMIRA MRRUKU TIRANE

Buxheti i vitit 2015 bazohet në një rritje progresive të taksave dhe varfërim të qytetarëve, kështu është shprehur ish-ministri i Financave, Ridvan Bode mbrëmjen e djeshme në emisionin "5 Pyetjet nga Babaramo". Bode u shpreh se programi i qeverisë për buxhetin e vitit të ardhshëm është agresiv, pasi ka rritje të konsiderueshme taksash. Ai akuzoi qeverinë, e cila sipas tij përshpejtoi afatet e diskutimit në parlament për të mbyllur diktatimin publik të tij me grupet e interesit. "Qeveria beson se me anë të kërbagjit do të mbledhë më shumë të ardhura në buxhetin e shtetit. Vetëm rreth 10 % e tij do të vijë nga biznesi apo kompanitë përmes taksave mbi të, dhe barra më e madhe bie mbi qytetarët. Rritja e taksave në këto dimensionet është mbi qytetarët, ndërkohë që është stopuar rritja e pagave dhe pensioneve. Ka gjasa që 2014 të mbyllet me një rënie ekonomike. Rritja 2 % për vitin 2014, do të thotë rritje prej 1.4 % për 2013. Por qeveria për këtë vit të kaluar foli ndryshe, duke e paraqitur në shifra më të ulëta", tha ish ministri i Financave Ridvan Bode. Ndërkohë, Bode theksoi se thellimi i deficitit për këtë vit është 10 %, i shprehur se në çdo vit ka patur deficit, por ky vit arrin në ekstrem. Nga ana tjetër ai prek edhe çështjen e kreditimit në vendin tonë, ku thotë se në 6 mujorin e parë të këtij viti kemi patur një rritje të kreditimit. Ai thotë se niveli i kreditive të

# Bode: Programi qeverisë për buxhetin është agresiv

## Buxheti 2015 rritje progresive taksash, varfërim të qytetarëve

### VIZITA

Basha në Bruksel, larg klimës së buxhetit.



Ndërkohë që në Parlament qeveria bën diskutimin mbi projektbuxhetin e vitit 2015, kreu i opozitës Lulzim Basha ikën në Bruksel, për të marrë pjesë në punimet e asamblesë politike të PPE. Asambleja politike është takimi më i rëndësishëm i Partive Popullore Europiane, formacioni që dominon e BE dhe vendet anëtare. Kreu demokrat Basha, pritet të ketë takime me personalitete të rëndësishme në këtë asamble ku marrin pjesë kryeministra dhe funksionarët më të lartë të KPE-së.

**Qeveria**  
Investimet publike për qytetarët janë më të ulëta nga viti 2010, 2011, 2012. Nuk kanë shtuar asnjë fond për investime.



Ridvan Bode mbrëmjen e djeshme në emisionin "5 Pyetjet nga Babaramo"

### Parashikimi

Ka gjasa që 2014 të mbyllet me një rënie ekonomike. Rritja 2 % për vitin 2014, do të thotë rritje prej 1.4 % për 2013

këqija po rritet në mënyrë të frikshme në bankat e vendit tonë. Në gjykimin e tij, është energjetika që ka krijuar deficit, dhe industria të tjera që lidhen me import-eksportin. Më tej, deputeti demokrat theksoi se buxheti 2015, ka ndrydhje të investimeve në sektorin privat. Në gjykimin e tij, paqja se qeveria programon rritje shumë optimiste, gjithçka mbetet në kuadrin e deklaratave boshe. Me programin e ri të qeverisë për buxhetin, sipas Bodes bizneset do të punojnë 7 muaj për qeverinë dhe 5 muaj për veten e tyre. "Nga 800 mln dollar në total, nga këto

460 mln dollar do t'i marr qeveria, 340 mln dollar janë për qytetarët. Me këto do paguaj qeveria rritjen e pagave, investimet etj? Kështu i bie që bizneset të punojnë 7 muaj për qeverinë e 5 muaj për vete, as vendet nordike se kanë këtë praktikë", tha

nënkryetari i Komisionit të Ekonomisë, Ridvan Bode. I pyetur rreth investimeve publike të bëra nga qeveria Berisha dhe shlyerjes së detyrimeve të prapambetura nga qeveria aktuale, Bode tha se investimet publike për qytetarët janë më të

ulëta nga viti 2010, 2011, 2012. Ai tha se qeveria nuk ka shtuar asnjë fond për investime. "Nuk ka asnjë investim të ri në asnjë komunë, as rrugë, as shkollë, as spital. Thjesht vënë një zë në buxhet si buzëkuq për investimet e bëra më parë. As rruga Tiranë-Elbasan nuk ka përfunduar ende, duke bllokuar edhe segment të tjera. Vetëm shpenzimet administrative të qeverisë janë rritur. Shtohet buxheti i Ministrisë së Brendshme", theksoi Bode. Më tej ai e vuri theksin tek ajo çfarë kryeministri Rama deklaroi dje në Parlament tek rritja e numrit të punonjësve në radhët e policisë. Bode tha se pasi qeveria rriti pagat e policëve në fillim të vitit, tani shton numrin e forcave blu, ndërkohë që nuk po bën asnjë investim në arsim dhe në shëndetësi. "E ka fokusin vetëm tek fasada, siç ka bërë gjithmonë, por nuk ka asnjë investim anë e mbanë vendit", deklaroi ai. Sa i përket skandalit në Bankën e Shqipërisë, Bode tha se paqja asaj çfarë ka ndodhur, për qytetarët me rëndësi është të gjendet një zgjidhje. Ndërkohë ai theksoi se është drejtësia ajo që i shkon në fund këtij procesi. "Nuk me interesojnë ato që janë bërë publike, pasi shpesh ka deklarime të influencuara, ajo që ka rëndësi është ajo që do deklarohet drejtësia në fund. Unë e konsideroj një incident shumë të rëndë", tha Bode.



### Çlirimi TIRANE

**P**olitika shqiptare ishte sërish e ndarë në 70-vjetori i çlirimit të Tiranës nga forcat ushtarake gjermane. Mazhoranca dhe opozita nuk kanë mundur të qëndrojnë bashkë dhe në këtë ditë të shënuar për kryeqytetin por janë munduar të bëjnë politikë. Kështu dje kryeministri Edi Rama, kryeparlamentari Meta, ministri Kodheli, Nikolla dhe ministrat e tjerë të kabinetit qeveritar e deputetët të PS dhe aleatë i zhvilluan homazhet në ceremoninë e mbajtur nga Prefektura. Ajo që ra në sy në ceremoni të "Ushtari i Panjohur" ishte prania e fotografive të ish-diktatorit të komunizmit, Enver Hoxha të mbajtura nga veteranët e luftës e dashamirës të figurës së tij. Ndërkohë që Bashkia e Tiranës bëri homazhe në nderim të të rënëve të luftës të Dëshmorët e Kombit pranë Monumentit "Nënë Shqipëri" ku opozita i është bashkuar festimeve të Bashkisë. Por prezencën e fotove të ish-dik-

**"70 vjetori, mirënjohje përjetë bive dhe bijave të këtij qyteti që luftuan dhe dhanë jetën për liri", shkruan Basha.**

### Reagimi TIRANE

**P**D ka akuzuar qeverinë se po vë në jetë projektin e rehabilitimit të figurës së diktatorit Enver Hoxha. Sipas tij me Enver Hoxhën në sfond, ata provokuan dje të gjithë shoqërinë. "Edi Rama dhe Ilir Meta, zyrtarisht konfirmuan dhe e vunë në jetë projektin e tyre për rehabilitimin e figurës së diktatorit Enver Hoxha. Me fotot e Enverit pas shpatullave me korin e Enverit në sfond, Rama e Meta, gjetën mënyrën më të turpshme për të baltosur 70 vjetorin e çlirimit të Tiranës. Duke përkujtuar këtë ditë të shënuar, me diktatorin Hoxha, tha kanë fyer kujtimin e dhjetra intelektualëve, heronjtë e vërtetë të luftës, të cilët u vranë dhe u lincuan drejtpërdrejt nga dora e Enverit", thotë Paloka. Sipas të cilit, ata kanë fyer sakrificat e dëshmorëve të luftës, të cilët dhanë jetën për lirinë e vlerat europiane, vlera që i përdhosi diktatori Hoxha. "Me Enver Hoxhën në sfond, Edi Rama



### FESTIMET

## Hoxha

70-vjetori i çlirimit të Tiranës festohet i ndarë, veteranët shfaqen me portrete dhe thirrje për Enver Hoxhën. Debate mes opozitës dhe mazhorancës.



## Pozita

Kryeministri Edi Rama, kryeparlamentari Ilir Meta, ministrat dhe deputetët kanë marrë pjesë në një ceremoni të organizuar nga Prefektura të "Ushtari i panjohur".



## Mungesa

Bashkia e Tiranës e ka përkujtuar këtë ngjarje të "Varrezat e Dëshmorëve". Në mungesë të Lulzim Bashës, që ndodhet në Bruksel, ceremonia është drejtuar nga Enno Bozdo.



# Politika e ndarë, Rama: Të fandaksurit kapen pas Hoxhës

## Në 70 vjetorin e çlirimit të Tiranës mungojnë Basha-Berisha

tatorit Enver Hoxha ka sjellë debate në politikë, ku Berisha dhe Basha, asnjëri pjesëmarrës në këto festime, njëri në zyrën e tij, tjetri në Bruksel, kanë akuzuar Ramën. Kryeministri ka reaguar në lidhje me pjesëmarrjen e disa veteranëve të luftës që mbanin në duar pankarta me portretin e komandantit të LANÇ Enver Hoxha, gjatë ceremonisë për 70-vjetorin e Çlirimit të Tiranës. Ai shkruan se ndjen keqardhje për këtë veprim, që sipas tij e kanë bërë njerëz që s'ishin të ftuar në këtë ceremoni. Në lidhje me akuzat e opozitës, kryeministri Rama shkruan se ndjen keqardhje për ta duke përdorur fotot e Enver Hoxhës, për të bërë luftë politike. "Keqardhje për të



Dje gjatë festimeve tek "Ushtari i Panjohur"

paftuarit që futen si diversantë nëpër turmat e aktiviteteve përkujtimore të çlirimit, për të ngritur fotografitë e Enver Hoxhës. Keqardhje për të fandaksurit që kapen pas fotografive të Enver Hoxhës, për të bërë luftë politike

me ne. Të dyja palët janë e shkuara e këtij vendi i cili s'ka kohë për të humbur me marrëzitë e tyre! Të vdekurit me të vdekurit, të gjallët me të gjallët", shkruan Rama në Facebook. Rama, Meta, ministrat e deputetët socialistë vendosën kurora me lule pranë monumentit të Ushtarit të Panjohur. Ndërkohë opozita i bashkohet ceremonisë së Bashkisë së Tiranës, por mungon Basha e Berisha. Ra në sy prania e kreut të grupit të PD Paloka, deputetes Bregu, deputetëve Mima, Islami etj. Ndërsa lideri i opozitës Basha që ndodhet në Bruksel uroi nga Facebook. Të frymëzuar nga sakrificat e të rënëve për t'i dhënë Shqipërisë të ardhme! Kryetari i Bashkisë së Tiranës Lulzim Ba-

sha, njëherësh lideri i opozitës nuk mori pjesë në përkujtimin e 70-vjetorit të çlirimit të Tiranës pasi ndodhet në Bruksel ku merr pjesë në punimet asamblesë politike të PPE. Por ai e ka uruar këtë ditë përmes një statusi në rrjetin social Facebook, duke e cilësuar një ditë të madhe.

**"Të dyja palët janë e shkuara e këtij vendi i cili s'ka kohë për të humbur me marrëzitë e tyre! Të vdekurit me të vdekurit", shkruan Rama.**

# PD: Enveri në 70 vjetorin e çlirimit të Tiranës, provokim

Paloka: Rama dhe Meta po rehabilitojnë diktatorin komunist

### Ambasadori i SHBA

## Arvizu: Fotot e Hoxhës fyerje për shqiptarët

— Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, ka përshëndetur sot nëpërmjet një mesazhi të shpërndarë në rrjetin social Tëitër, 70 vjetorin e Çlirimit të Tiranës, por nuk ka nguruar të shënjestrojë fotot e diktatorit në këtë ceremoni. Diplomati amerikan është shprehur se prezencën e këtyre fotove në ceremoni e njollosën atë. Fotoja siç tha ai më tej është fyerje për shqiptarët. Për shfaqjet e fotove të diktatorit Hoxha dhe thirrje pro tij në ceremoninë e organizuar tek memoriali i ushtarit të Panjohur ka reaguar edhe Partia Demokratike, e cila akuzon kryeministrin Rama dhe kreun e Kuvendit Meta se po rehabilitojnë figurën e diktatorit.



Kreu i grupit të PD, Edi Paloka

### Akuza

"Me fotot e Enverit pas shpatullave me korin e Enverit në sfond, Rama e Meta, gjetën mënyrën më të turpshme për të baltosur 70 vjetorin e çlirimit të Tiranës".

e Ilir Meta, provokuan gjithë shoqërinë tonë, dhe plagët e saj më të dhimshme të periudhës së shkeljes brutale të dinjitetit njerëzor, të plagëve të urisë që solli diktatori për më shumë se 40 vite. Duhet të ishte dita për të bashkuar gjithë shqiptarët

pavarësisht preferencave politike, në nderim të të rënëve, në nderim të luftës së tyre, por Rama zgjodhi kursin e përçarjes, duke provokuar e duke baltosur sakrificat më të larta njerëzore që u bënë në emër të lirisë e kombit", tha Paloka.

### RAMA/LSI:

Lufta e LANÇ, më e lavdishmja për atdheun

— Sekretari i Përgjithshëm i LSI, Luan Rama me ftesë të Kryesisë së Organizatës së Veteranëve të LANÇ mori pjesë në aktivitetin përkujtimor të organizuar nga kjo organizatë në nder të çlirimit të Tiranës. Ai vlerësoi rolin dhe kontributin e partizanëve dhe të popullit në luftën kundër pushtuesve nazifashist. Rama u shpreh se data e djeshme shënon dhe kurorëzimin e luftës më të lavdishme dhe më heroike që ka bërë populli shqiptar gjatë gjithë historisë së vet të mbushur me luftëra dhe me sakrificat.

## » KENGETARI

**MJEKËSIA** Ligjore bëhet me dije se nga ekspertiza paraprake dyshohet se vdekja ka ardhur si shkak i mbingarkesës së trupit me substanca narkotike, gjë që dyshohet se ka stimuluar vdekjen e këngëtarit 35-vjeçar

# Shuhet artisti rebel, lë gjurmë në pentagramet muzikore


Doktor Flori ka humbur jetën rreth orës 10:30 nga probleme në zemër, lë pas gruan dhe dy fëmijë

### Liderët



#### Kryeministri

"Lamtumirë, miku im gjenial!" Këto janë fjalët e ngushëllimit, që Kryeministri Rama ka drejtuar publikisht për mikun e tij Dr.Flori, i cili ndërroi jetë sot pas një ataku kardiak.



#### Basha

"Tronditës lajmi për ndarjen tragjike nga jeta të Doktor Florit. Ngushëllimet e mija familjes, miqve dhe fansave të tij" - shkruan kryebashkiaku Luizim Basha.

#### Berisha

"Sot zi në këngën dhe muzikën tonë! Me Doktor Florin kemi humbur një këngëtar vërtet të madh, familja njeriun më të dashur. Ngushëllime të sinqerta familjes, miqve dhe fansave të panumërt të Doktor Florit. Ai mbetet i gjallë në këngën e tij!

IZAURA NDOJ  
TIRANE

Këngëtari i mirënjohur shqiptar, Florian Kondi, ose i njohur ndryshe si Doktor Flori, ka humbur jetën mëngjesin e djeshëm. Lajmi tronditës është konfirmuar nga burime pranë urgjencës së spitalit në QSUT "Nënë Tereza". Doktor Flori ndërroi jetë mëngjesin e djeshëm në një moshë të re dhe la pas dy fëmijë, një vajzë 7 vjeç dhe një djalë të vogël, i cili ka vetëm tre muaj që ka lindur. Urgjenca e QSUT-së konfirmoi se i riu mbërriti pa jetë rreth orës 10:30 minuta në spital. Shkak i vdekjes së këngëtarit dyshohet se ka ardhur nga një overdozë kokaine. Referuar të dhënave që vijnë nga Mjekësia Ligjore bëhet me dije se nga ekspertiza paraprake dyshohet se vdekja ka ardhur si shkak i mbingarkesës së trupit me substanca narkotike, gjë që dyshohet se ka stimuluar vdekjen e këngëtarit 35-vjeçar. Ndërkohë, pritet pikërisht rezultati përfundimtar i ekspertëve mjeko-ligjor, për të mësuar edhe shkaqet reale të ndarjes nga jeta të "Dr Florit" paraditen e djeshme.

#### NGJARJA

Burime nga spitali thanë se, 35-vjeçari ka mbërritur pa frymë atje. Edhe pse reagimi i mjekëve ka qenë i shpejtë dhe atij i është injektuar insulinë, Dr. Flori nuk është kthyer më në jetë. Florian Kondi ose Dr. Flori ka lindur më 28 shkurt 1979. 35-vjeçari ka lënë pas dy fëmijë, një vajzë dhe një djalë, i cili ka vetëm disa javë që ka lindur. Si për ironi të fatit, këngëtari që aq shumë i ka kënduar Tiranës, u shua pikërisht në ditën e Çlirimit të Tiranës.

#### SHKAQET

Mësohet se shkaqet që mund ta kenë çuar drejt vdekjes Dr. Florin kanë të

bëjnë me një gjendje të thellë depresive që ka shfaqur gjatë javës së fundit. Nga burime të njerëz të tij afërm mësohet se këngëtari i njohur ishte në një gjendje jo të mirë në javët e fundit. Shkak për këtë mësohet të ketë qene një problem shëndetësor i birit të tij të porsalindur për kurimin jashtë të të cilit, ai nuk kish arritur dot të siguronte të ardhura.

Edhe pse të gjitha shkaqet të çojnë tek përdorimi i lëndëve narkotike, artisti kontrovers pati dhënë një mesazh shumë të madh në daljen e tij më të fundit: "Ashu të merr ajo (droga). Nuk e kontrollon dot atë... Rreziku është i madh. Është armë e fuqishme. Rreziku është i madh që të të munda droga, jo ta mundë njeriu drogën, dmth ta kontrollojë".




Dr Flori

**VIDEO/ NDAHET NGA JETA KËNGËTARI I NJOHUR SHQIPTAR 'DOKTOR FLORI'**

Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të AIREPORT që shkarkohet falas

### Qëllimi

## Dr. Flori, artisti që i këndoi problemeve sociale



— Dr. Flori e nis karrierën e tij shumë vite më parë, kur në Shqipëri nisën të krijohen grupet e para rep. Ish- anëtar i grupit "West Side Family", baba i dy fëmijëve ka shumë këngë të njohura në repertorin e tij. Dr.Flori do të kujtohet si pjesë e grupit "West Side Family", por edhe si kompozitor dhe autor i shumë këngëve të tij, ku në fokus kishin mesazhin e problemeve sociale. Vetëm pak muaj më parë, Dr.Flori bashkë me skuadrën e Saimir Tahirit realizuan një këngë për policinë. Nën titullin "Së bashku", ky mesazh vjen në formën e një klipi të sjellë nga Dr. Flori dhe Mariza Ikononi. Në këtë videoklip shfaqen forcat të policisë dhe kryesisht femra, të cilët tregojnë gatishmërinë për të mbrojtur qytetarët. Ndërsa, gjatë sezonit veror solli një tjetër bashkëpunim të suksesshëm me Ermal Mamaqin, me këngën "Mos pi mall, bëj palestër", klip i cili sërish trajtoi një problem social.





● **NË FOTO:** Miqtë dhe të afërm të Rr. Florit në morgun e tiranës



**Homazhet**

Sot në orën 09:00- 12:00 në hollin e godinës së RTSH-së do të mbahen homazhe në nderim të artistit të larguar para kohe nga jeta

**Hitet e Dr. Florit**

- 2010 - Origjinale (feat. Aurela Gaçe & Marsele)
- 2011 - Ça po menon (feat. Anila Jonuzi)
- 2011 - Ça na ke
- 2011 - S'ma ndjen
- 2011 - Bota nuk është bardhë e zi
- 2011 - Personale
- 2012 - Pasion (feat. Fatima Ymeri)
- 2012 - Tune tune (feat. Fatima Ymeri)
- 2012 - Ka kalle (feat. Noga)
- 2012 - Ku ka si Tirona (feat. Ermal Mamaqi)
- 2012 - Jam ti! (feat. Fabi)
- 2013 - Zemërthyer (feat. Tiri)

# Lamtumirë Dr. Flori!

## Ja pengjet e mbetur në mes

Vdekja e kantautorit, artistë dhe politikanë shprehin ngushëllimet

**IZAURA NDOJ**  
TIRANE

**KUSH ISHTE DOKTOR FLORI**


**S**a herë mërzhitem kur dhimbja më trishton, e sa herë dhimbja më ikën se gëzimi ma largon... Se suksesi me dëshitim bashkë të dy jetojnë, në çdo kohë ndodh kështu, dua të them se jeta shkon..." Florian Kondi, krijuesi i qindra teksteve dhe melodive që edhe pas një dekadë vazhdojnë të mbeten hite, është ndarë nga jeta vetëm fizikisht, sepse emri dhe muzika e tij janë gdhendur thellë në zemrat e të gjithëve. Këngëtarin i famshëm Florian Kondi, i njohur për mbarë publikun shqiptar si Doktor Flori është ndarë nga jeta gjatë ditës së djeshme, lajm ky shokoi jo vetëm miqtë dhe artistët, por edhe mbarë opinionionin publik. Krijuesi i grupit muzikor mjaft të njohur dhe të pëlqyer nga të rinjtë "West Side Family", nuk ka pas vetëm një karrierë të pasur artistike, por edhe mjaft projekte të lëna në mes, ku mes tyre është dhe bashkëpunimi i fundit që pritej të vinte me mikun e tij, Ermal Mamaqin. Një projekt ky që duket se do të marr jetë pa praninë e tij fizike, por me nota e fjalë prej një artisti të vërtetë. "Ditët e fundit i kemi kaluar në skenën e Calvin, një skenë që na ofroi së bashku dhe një skenë që na ndau. Të premtën do të nxirrim dhe reklamën se Dr. Flori do të ishte krah meje, Aurelës dhe Endrit, grupit tonë artistik të live-t. Një projekt ky që na gëzoi të gjithëve, por dhe na hidhori zemrat", kështu e kujton Stefi Pritfi, këngëtarin i cili ia pas gjurmë jo vetëm në pentagramet e muzikës shqipe, por në zemrat e gjithë shqiptarëve.

Doktor Flori njihet për daljet e tij në publik që në kohë të hershme. Ai është shfaqur 12 vjet më parë si pjesë e grupit "West Side family", në vitin 2002 me këngën "Mesazh", e për të vijuar me një sërë këngësh mjaft të suksesshme si: "Hou Cike", "Nëse mundesh" "E gjithë bota jemi dy", e shumë këngë të tjera. Këngët e tij kanë trajtuar gjithmonë probleme të mëdha sociale, siç është droga, në këngën "Mos pi mall, bëj palestër", bashkëpunim me mikun e tij Ermal Mamaqi. Ndërsa Doktor Flori, si pjesë e grupit mjaft të njohur "West Side Family" do të mbahet mend edhe për bashkëpunimin me ish-kreun e Bashkisë së Tiranës dhe ish-kreun e opozitës, tashmë kryeministër, Edi Rama. Kënga e parë e debutuar nga ta, ishte "Tirona", prej nga doli edhe shprehja "Gjithçka mund të ndodhë, jetojmë në Tironë". Më pas ky bashkëpunim u pasua në vitin 2009 me këngën "Çohu". Gjithashtu Dr. Flori ka qenë pjesë e një video sensibilizuese, e cila thekson funksionin dhe rëndësinë e policisë. Njëpër një klipit "Së bashku" të kënduar prej tij dhe këngëtares Mariza Ikononi, ku kanë marrë pjesë edhe personazhe të tjerë të njohur. Këngëtarin me origjinë nga Kuçova, pas ndarjes nga grupi "West Side Family" e ka vijuar karrierën e tij si solist. Ai ka qenë edhe fitues i edicionit të tretë të reality show-t "Vip Shpija" në Kosovë, fitore që siç e cilësoi ai erdhi pikërisht sepse ishte konkurrenti më i sinqert. Duke lënë pas një karrierë të pasur, që kurse kënga e tij më e re, e cila fatkeqësisht do të jetë dhe e fundit është ajo me titull "Toke Toke".

**Reagojnë artistët**



**Flori Mumajesi:** "Më duket si ëndërr, si ajo kënga e parë që kënduam bashkë kur nisëm të ëndërronim. E di që askush nga ne nuk është i përjetshëm, por ti u largove shumë shpejt. Qofsh në paqe, por nuk mundem dot të them 'Lamtumirë', nuk mundem dot Flor sepse shpirtin tënd na a e ke lënë në çdo varg që ke shkruar, në çdo këngë që ke kënduar të cilat do tingëllojnë përjetësisht plot jetë."



**Landi Hysi:** "Vazhdimisht më pyesnin: U nda grupi "WEST SIDE FAMILY"? Kur do riktheheni? Pra, u ribashkuat... Gjithmonë buzëqeshja e u thosha "Ju falenderoj për interesimin dhe dashamirësinë e treguar, por lavdi Zotit të tre çunat janë mirë me shëndet e për rrjedhojë s'ka ndarje, thjeshtë grupi ka qenë me pushime. Më iku (fizikisht) DR. FLORI! Asgjë dhe askush nuk ma rikthen! Një dhimbje e tipit ferri mbi tokë, por që fjalët nuk do mjaftojnë për t'u shpjeguar! Të lutëm Zot ta marrësh pran teje. U presh në paqe o Dr. Flori!! Vajtoj pafund në heshtje... Sigurisht Flor, kjo që bëre sot është e vetmja këngë e jotja që nuk më pëlqen, por ato që ti bëre në jetë, do të oshojnë mbi tokë."



**Juliana Pasha:** Këngëtarja Juliana Pasha në një postim në profilin e saj në "Instagram" bën fajtorë drogën për vdekjen e Dr. Florit dhe shpreh dhimbje për këtë humbje. "Droga merr një tjetër jetë, por këtë herë bëhet fjalë për një artist shqiptar. Dr. Flori - Florian Kondi. Nuk ka fjalë për t'u shprehur, ka vetëm dhimbje për këtë humbje të papritur. Zoti qoftë me shpirtin tënd Flori!"


- Rozana Radi:** Do t'na mungosh të gjithëve mik i mirë.
- Sidrit Bejleri:** Lamtumirë mik! Zoti të mëshiroftë!
- Rozarta Shkurta:** "Një princeshë e vogël 7 vjeç dhe një ëngjëll i vogël 2 muajsh sot humbën heroin e tyre. Ne humbëm një artist shumë të talentuar dhe një mik të mirë... U presh në paqe Dr. Flori!"
- Jeta Faqolli:** "R.I.P Dr. Flori. Ishë shumë i ri për tu larguar nga kjo jetë!"
- Soni Malaj:** "U presh në paqe miku im Flori, nuk do të harroj kurrë"
- Besa Kokëdhima:** "RIP Dr. Flori! Ngushëllimet e thella për familjen!"
- Eranda Libohova:** "Të shkoftë shpirti në parajsë Flori!"
- Çljeta Xhilaga:** "O Zot s'më besohet, paska qenë një muaj shumë i hidhur ky nëntor. U presh në paqe o Flori siç ke emrin ashtu ishe dhe si njeri!"



**Elton Deda:** "Nuk di ç'të them vërtet...di të them vetëm që jeta është gënjeshtrë. Një artist, një baba, një njeri... Artisti jeton për të lënë një gjurmë, babat për të lënë pasardhës dhe njeriu për të bërë gjëra të mira. Besoj se i ke realizuar të gjitha mikui im. Do donim të të kishim për shumë kohë mes nesh, por fluturove shpejt. U presh në paqe Flori!"



**Eneida Tarifa:** Në një postim në profilin e saj në "Instagram" Eneida Tarifa shkruan, "Të prehesh në paqe or mik por nuk e bërë mire... Dr. Flori gjithmonë në zemrat tona..."



**Julian Deda:** "Nuk e besoj dot. Nuk dua ta besoj. Pse o vlla ike kështu??? O Zot merr në mbretërinë tënde këtë zemër artistin. Lamtumirë mikui im, lamtumirë koleg, lamtumirë artist, lamtumirë o njeri i mirë. Më vjen shumë keq që na detyrove të ëë themi "LAMTUMIRË", më vjen të plas nga inati. Do kujtoj gjithë jetën batutën, energjinë dhe shpërthimet e tua artistike. Do më mungosh, do i mungosh Shqipërisë. Respekt përjetë për ty Flori, u presh në paqe..."



**Elia Zaharia:** "Trishtim i thellë mik i vjetër, mik i talentuar! E di që Zoti, që ti e deshe aq fort, të pret me krahë hapur në parajsë, por këtu poshtë ne do na marrë malli për ty dhe tingujt e zemrës tënde."

■ TË PENDUAR

Mes shumë dëshmitarëve, në gjyqin ndaj grupit të tritolit do përdoren dhe dy dëshmitë të penduarve Sinanaj dhe Gjokona

**VIDEO/ MARJAN MITRO, DERVISHAJT I KAM SHERBYER SI KUZHINIER**

Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të A1REPORT që shkarkohet falas



# Biznesmenë e VIP-a dëshmitarë në gjyqin e bandës së tritolit

Zbulohet lista me 133, mes tyre e Enkelejda Konomi Ndërtuesit e pallateve, Dervishi e Kollozi në gjyq



Gjykata e Krimeve të Rënda

**ELTON QYNO**  
TIRANË

**B**iznesmenë të njohur në Tiranë, Durrës, Vlorë si dhe zyrtarë të lartë të shtetit, janë përfshirë në listën me 133 emra si dëshmitarët që do paraqiten para gjykatës për të dëshmuar në procesin kundër grupit kriminal që lidhte "kontratën e vdekjes". Mes personave që do dëshmojnë janë dhe ish e fejuara e Julian Sinanaj, Denada Çuni, biznesmeni i ndërtimit Tanush Mëhilli, Piro Bare, ortaku i Marion Mitros në biznes Andrea Petani, ish-kandidati për deputet i PD në Vlorë, Ardian Kollozi, ish-prefekti i Vlorës Besnik Dervishi, e shumë personazhe të tjerë. Lista e 133 dëshmitarëve është vetëm e prokurorisë, pa përfshirë këtu dhe emrat e tjerë të njohur që do thiren në gjykatë nga avokatët mbrojtës për të dëshmuar në gjyqin e 7 personave të arrestuar për një sërë akuzash shumë të rënda. Mes personave të ndaluar është dhe biznesmeni fterak i gazit Ilir Karçini, i cili akuzohet për sigurimin e mjeteve për të vrarë, biznesmenin tjetër të gazit Piro Bare.

**GRUAJA E KONOMIT!**

Emri i Enkelejda Konomi, bashkëshortes së gjyqtarit të ndjerë Skerdilajd Konomi, është listuar nga prokuroria si një ndër 133 dëshmitarët që do japin shpjegimi në gjykatë. Nuk dihet me saktësi nëse bëhet fjalë ekzaktesisht për Enkelejda Konomin, gruan e gjyqtarit, për shkak se për një gjë të tillë burime pranë prokurorisë nuk dhanë një version zyrtar nëse bëhet fjalë për gruan e gjyqtarit të vrarë në Vlorë me shpërthim të telekomanduar. Vetë dy të penduarit e këtij grupi Julian Sinanaj dhe Ndrichim Gjokona në dëshminë e tyre kanë treguar rreth asaj që dinin për ekzekutimin me tritol të gjyqtarit, por që nga ana e prokurorisë nuk pati

asnjë arrestim dhe nuk është ngritur asnjë akuzë ndaj asnjë personi të arrestuar për këtë ngjarje. Ndërkohë një verifikim që gazeta "Shqiptarja.com" ka kryer, rezultoi se me emrin "Enkelejda Konomi" banojnë në qytetin e Vlorës, tre shtetase. Nisur nga kjo

situatë, ka shumë gjasa, megjithëse nuk përjashtohet, që në listën e dëshmitarëve të prokurorisë, të jetë jo gruaja e gjyqtarit Skerdilajd Konomi.

**METUSHI NË GJYKATË**

Njeriu që ishte planifikuar

të vritej nga banda e tritolit Julian Metushi, do japë dëshminë në gjykatë, lidhur me konfliktet që ai ka pasur me anëtarët e këtij grupi. Veç tij, në gjykatë do dëshmojë dhe djali i Sokol Veizit, Elis Veizi dhe bashkëshortja e nëna e të ndjerit. Në listë

janë përfshirë dhe familjarët e biznesmenit Agron Çela, i vrarë me tre plumba nga Julian Sinanaj. Mes shumë dëshmitarëve, në gjyqin ndaj grupit të tritolit do përdoren dhe dy dëshmitë e të penduarve Julian Sinanaj dhe Ndrichim Gjokona.

**DËSHMIA**

**Piro Bare: Ilir Karçini i vetmi që do më bënte keq**



Piro Bare

— Biznesmeni i gazit Piro Bare, gjatë dhënies së dëshmisë së tij në Prokurorinë e Krimeve të Rënda, ka deklaruar se i vetmi person që mund t'i bënte keq atij, ishte Ilir Karçini. Sipas rrëfimit të Bares, Karçini herë pas here e ka kërcënuar dhe se këto kërcënime kanë ardhur jo direkt nga ai por nga biznesmenë të tjerë. Dëshmia e Bares është marrë në një kohë kur prokuroria ende nuk kishte identifikuar dhe arrestuar shtetasin Karçini. Pas kryerjes së verifikimeve, është bërë e mundur identifikimi i këtij biznesmeni, dhe më pas kanë qënë forcat RENEAA ato që kanë arrestuar Karçinin brenda në zyrën e tij në Tiranë. Karçini, asnjëherë nuk ka pranuar akuzën e ngritur nga prokuroria duke pohuar se nuk e kishte takuar ndonjëherë Julian Sinanaj.

## Lista e dëshmitarëve të Prokurorisë

- |                        |                        |                            |                       |
|------------------------|------------------------|----------------------------|-----------------------|
| 1) Erion Simoni        | 35) Françesko Çaushaj  | 68) Bujar Bodo             | 101) Mustafa Shtylla  |
| 2) Zabit Dervishi      | 36) Fitim Ribaj        | 69) Astrit Ribaj           | 102) Adriatik Avdia   |
| 3) Denada Çuni         | 37) Tomor Çapaj        | 70) Marjot Ribaj           | 103) Akim Xhelilaj    |
| 4) Arber Çuni          | 38) Enxhell Haxhiraj   | 71) Adriatik Brahimi       | 104) Enkelejda Konomi |
| 5) Romeo Çuni          | 39) Selim Liço         | 72) Bledar Zeiraj          | 105) Alfred Ajdinaj   |
| 6) Fatbardha Pema      | 40) Gjergji Meleqi     | 73) Xhevdet Zeiraj         | 106) Gjergj Delilaj   |
| 7) Lumo Khani          | 41) Nazar Ymeri        | 74) Violeta Zeiraj         | 107) Anjola Gjinkuri  |
| 8) Ardian Kollozi      | 42) Erjon Isai         | 75) Ferik Halilaj          | 108) Eni Curra        |
| 9) Arqile Minxha       | 43) Shpresa Mëhillaj   | 76) Arben Hitaj            | 109) Erlinda Memia    |
| 10) Theleza Çobo       | 44) Riko Mëhillaj      | 77) Steljana Çela          | 110) Përparim Leka    |
| 11) Selam Nervaj       | 45) Elis Veizi         | 78) Agim Skëndaj           | 111) Leonard Shehaj   |
| 12) Petrit Behaj       | 46) Gladiola Veizi     | 79) Harli Xhyheri          | 112) Toni Shquti      |
| 13) Jorlend Hitaj      | 47) Naze Veizi         | 80) Ylli Çela              | 113) Majlinda Koni    |
| 14) Gerard Birçe       | 48) Leonard Musaraj    | 81) Entela Dautaj          | 114) Eni Guçe         |
| 15) Dorian Behaj       | 49) Ferdinand Xhindola | 82) Rajmonda Çela(Mehmeti) | 115) Zamir Brahimi    |
| 16) Fuat Muka          | 50) Enea Nexhipaj      | 83) Hamza Xhyheri          | 116) Klevis Bleta     |
| 17) Violeta Zeiraj     | 51) Arben Nexhipaj     | 84) Edmond Rexho           | 117) Aziz Gura        |
| 18) Kastriot Çobo      | 52) Mehmet Nexhipaj    | 85) Agron Shehi            | 118) Ergys Hoxha      |
| 19) Zaim Caushaj       | 53) Eduard Feci        | 86) Klaudio Shehi          | 119) Ilir Hyseni      |
| 20) Glenis Çobo        | 54) Eris Shlaca        | 87) Roland Shehi           | 120) Petrit Doka      |
| 21) Erblin Kulla       | 55) Arsen Jupe         | 88) Pëllumb Bajrami        | 121) Viktor Menkshi   |
| 22) Fiqiri Xhaferri    | 56) Benard Kasa        | 89) Ela Mehmeti            | 122) Afrim Pali       |
| 23) Julian Ballushi    | 57) Dritan Kasa        | 90) Alesia Mehmeti         | 123) Ardian Aga       |
| 24) Astrit Birçe       | 58) Ilir Nexhipaj      | 91) Julian Metushaj        | 124) Selfo Hemollari  |
| 25) Jurven Malaj       | 59) Mehmet Nexhipaj    | 92) Andrea Petani          | 125) Imer Qarri       |
| 26) Shkëlqim Selami    | 60) Bajram Koka        | 93) Admir Mediaj           | 126) Haki Dauti       |
| 27) Bensik Jakupi      | 61) Panajot Meçaj      | 94) Bensik Dervishi        | 127) Piro Bareçaj     |
| 28) Sami Selfo         | 62) Robert Hamzaraj    | 95) Myrvet Ymeri           | 128) Shkëlqim Kaçi    |
| 29) Bedri Caushaj      | 63) Harun Haruni       | 96) Elkjer Pulaha          | 129) Ilir Kotini      |
| 30) Ëngjellushe Rrapaj | 64) Roland Ibrushi     | 97) Renald Paskali         | 130) Artan Serjani    |
| 31) Antoneta Kapinova  | 65) Tanush Mëhillaj    | 98) Aleksandër Zyka        | 131) Hair Ismailonji  |
| 32) Zigur Çela         | 66) Suzana Mukaj       | 99) Drite Osmanaj          | 132) Mentar Lulaj     |
| 33) Dorina Çobo        | 67) Mirela Gjonçaj     | 100) Bardhyl Leka          | 133) Stavro Dhima.    |





☎ 04 22 34 096 @ www.bankacredins.com ✉ shitja@bankacredins.com

## Është gjithmonë mirë kur dikush kujdeset për ty!

Për të gjithë ju që keni një depozitë apo një Kartë Visa të Credins Bank, përfitoni:

Ulje  
deri në

# 40%

në ekzaminim  
mjekësor

Sigurimi i jetës  
dhe shëndetit

# FALAS

për një vit

 **CREDINS** bank

 **SiCRED**  
Shoqëri Sigurimi Jete

Për ta përfituar ofertën dhe çdo informacion tjetër drejtoheni në sportelet e Credins Bank ose të SiCRED. Kjo ofertë është e vlefshme për 1 vit kalendarak, nga momenti që ju aplikoni dhe vlen për të gjithë klientët depozitues me mbi 100 mijë Lekë, që kanë një kartë VISA dhe/ose kanë një overdraft. Gjithashtu për Klientët Elitë banka ofron Falas edhe sigurim shëndeti për 1 vit kalendarak.

**Deklarata**  
TIRANE

# “Jam djali i Luiza Xhuvanit më lironi, do ju jap flori”

**Vrasja e katërfishtë ndodhi pas goditjes me shpullë**

Jam djali i Luiza Xhuvanit dhe nëse më lëshoni do tju jap edhe flori”. Kjo është fjalia e vetme që Kostandin Xhuvani autori i masakrës së katërfishtë në lokalitë e natës “Ante Grande”, i ka thënë efektivit të patrullës “Shqiponja” gjatë momentit të arrestimit. Në dosjen e prokurorisë së

Tiranës, evidentohet se konflikti ka nisur pas një debati banal dhe njëri prej viktimave, Enea Xhaja ka qëlluar me pëllëmbë 26-vjeçarin Xhuvani. Incident mes tyre ka ndodhur pranë banakut, dhe se pas kësaj ka ndërhyrë ish-efektivi i policisë, bodigard i lokalit, ku ka kërkuar daljen

jashtë të Xhuvanit. Ndërkohë shtetasi Enea Xhaja ka qëndruar brenda në lokal, së bashku me mikun e tij Edinson Jaho, ku është qetësuar situata. Më tej Xhuvani, është rikthyer sërish në lokal dhe sapo ka hapur derën është shprehur: “...çfarë kishit ju të dy...”, dhe më pas ka qël-


lur në drejtim të tyre. Në këtë moment në lokal është kthyer shoku i Xhuvanit, i arrestuari Erald Sida, i cili ishte larguar para krimit dhe që e ka pyetur Xhuvanin “... çfarë bëre kështu...”. Ndërsa Xhuvani, sipas dëshmitarëve, i ka thënë “...më duket se kam vrrarë edhe Arbërin...”.



Kostandin Xhuvani në sallën e gjyqit

**Operacioni**  
ELTON QYNO  
TIRANE

Një invalid rezulton të jetë drejtuesi i një grupi kriminal që tregtonte armë me qëllim trafikimin e tyre në drejtim të Greqisë. Sami Memo, sipas Prokurorisë së Krimeve të Rënda shfaqet mjaft aktiv në përgjimet telefonike, ku dallohet duke dhënë urdhëra dhe përcaktuar çmimet e shitjes së armëve. Këto biseda janë bërë mes tij, anëtarëve të tjerë të grupit kriminal dhe një oficeri policie, i cili nën maskën e blerësit ishte infiltruar brenda rradhëve të grupit, duke kryer hetime për llogari të Krimeve të Rënda. Të gjitha armët që bliheshin tek anëtarët e këtij grupi kriminal, më pas shkonin në drejtim të laboratorit shkencor të policisë kriminale, ku pasi ekspertoreshin dinin të rregullta mekanikisht. Sipas hetimeve, armët vinin nga Kosova dhe më pas kishin si destinacion Greqinë. Ndërkohë që çmimi i tyre vijonte nga 800 mijë lekë të vjetra, deri në 1500 euro.



Sami Mema në sallën e gjyqit

# Invalidi në trafik armësh, ia shiti agjentit të infiltruar

**Armët vinin nga Kosova, shiteshin nga 800 mijë lekë deri në 1500 € për në Greqi**

**MOMENTI I SHITJES**

Në vazhdim të hetimit të këtij procedimi penal shtetasit nën hetim Sami Mema, Shkëlqim Varaku, Çlirim Xhaja, Alban Mancja dhe Hergji Buli kanë mbajtur komunikime të vazhdueshme telefonike me qëllim shitjen e një sasie tjetër armësh. Pas disa komunikimeve e kanë lënë që të bëjnë shitjen e armëve. Në këtë mënyrë në orën 12:50 të datës 14 nëntor 2014 janë takuar në qytetin e Shijakut, tek vendi i qujtur “Katër rugët”, tek lokali “Mema”, shtetasit nën hetim Sami Mema, Shkëlqim Varaku dhe shtetasi që do të blinte armët për kryerjen e blerjes së simular të një sasie të madhe armësh. Pasi u ulën në kafe shtetasit nën hetim Shkëlqim Varaku e ka thirrur me telefon shtetasin tjetër nën hetim Artan Aruci i cili ka ardhur me mjetin e tij tip dhe kanë shkuar në banesën e Shkëlqimit. Aty kanë marrë dhe sjellë të banesa e Samiut një automatik me karikator me fishekë, një pistoletë TT me karikator me fishekë dhe



Armët e sekuestruara

dy pistoletat të markës Ekol me karikator dhe fishekë të futur në një thes plastik. Pasi i ka lënë armët tek banesa e Samiut mjeti ka shkuar tek lokali “Mema”, ku Shkëlqimi ka zbritur nga mjeti dhe në mjet ka hytur shtetasit nën hetim Sami Mema dhe mjeti është nisur për

**VIDEO / ARREST ME BURG PER 4 TRAFIKANTET E ARMEVE**

Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të AIREPORT që shkarkohet falas

në drejtim të Durrësit. Këta dy shtetas kanë sjellë në banesën e Samiut dy armë Automatike tip Kallashnikov së bashku me karikator me fishekë.

**NDALIMI NGA POLICIA**

Rreth orës 17:00 tek banesa e shtetasit nën hetim Sami Mema ka ardhur shtetasit nën hetim Bardhyl Domi dhe ka sjellë një armë automatik tip Kallashnikov dhe i ka thënë Samiut t’ia shiste për shumën

prej 30 000 lekë. Gjithashtu një shtetas tjetër me emrin Naim i ka sjellë shtetasit nën hetim Sami Mema tek banesa e tij një armë tip Skorpions me silenciator me karikator me fishekë dhe i ka thënë Saimiu për t’ia shitur për shumën prej 1400 Euro. Në kryerjen e këtyre veprimeve shtetasit nën hetim Sami Mema është ndihmuar dhe nga djali i tij shtetasit nën hetim Festim Mema i cili ka qënë prezent gjatë gjithë

**VENDIMI**

## Krimet e Rënda, në burg 4 trafikantët



— Gjykata e Krimeve të Rënda ka caktuar masën e arrestit në burg për katër personat e arrestuar për akuzën e trafikut të armëve. Sami Mima, Alban Mancja, Hergji Buli dhe Shkëlqim Varaku, kanë qënë të arrestuarit e parë që kanë dalë dje para gjykatës së Krimeve të Rënda, ku janë njohur me masën e sigurisë të “arrestit në burg”. Pavarësisht vendimit të gjykatës, katër personat iu drejtuar gjykatës së nuk janë përfshirë në asnjë trafik armësh dhe për pasojë kërkuan lirin nga qelia, duke u shprehur para gjyqtarit Dritan Hallunaj, caktimin e një mase me të lehtë. Kjo kërkesë u kundërshtua nga prokurori i cili renditi rastet kur të dyshuarit i kanë shitur agjentit të policisë, i infiltruar si blerës, armët dhe municionet luftarake që u sekuestruan në momentin e arrestimit. Ndërkohë për 4 të dyshuarit e tjerë Çlirim Xhaja, Artan Aruci, Festim Mema dhe Ervin Xhaja masat do të zhvillohen mesditën e së martës.

**LAJME shkurt**



Francesco Flori

## Hetime në Shqiptëri për gjyqtarin e EULEX

— Një grup hetimor i ngritur nga Prokuroria e Përgjithshme Shqiptare, po ndihmojnë kolegët e tyre të Kosovës në hetimin e akuzave për korrupsion kundër gjykatësit të EULEX Francesco Florit. Lajmi zbulohet nga agjensia BIRN, autoritetet e Kosovës besojnë se mes viteve 2009 dhe 2011, Francesco Florit pranoi premtime për rryshfete me vlerë të përgjithshme prej 750 mijë eurosh dhe mori një rryshfet prej 360 mijë eurosh “për të mohuar të gjitha provat në një gjyq për vrasje” ndaj të dyshuarve, Besnik Hasani, Shpend Qerimi dhe Nusret Cena ish-anëtarë të policisë së Kosovës.



Shpëtim Gjika

## Vendimi për Shpëtim Gjiken në datë 27 nëntor

— Gjykata e Tiranës do të shprehë më 27 nëntor për akuzat ndaj kryetarit të Bashkisë së Vlorës, Shpëtim Gjika dhe bashkë të pandehurve të tjerë të kësaj dosje. Prokuroria në seancën e kaluar kërkoi dënim me 4 vjet burg për kryetarin Gjika, i cili kërkoi drejtësi dhe pajfajësi nga togat e zeza.

kohës në banesë kur janë sjellë dhe depozituar armët dhe municionet. Në këtë moment ka ndërhyrë policia e cila ka kryer arrestimin në flagrancë të shtetasve të mësipërm në kryerje e sipër të veprës penale të “Trafikimit të armëve dhe municioneve”.



# I vdes vajza në taksì, i ati akuza të dashurit të gruas

Jorgo Anagnosti i kërkon Janinës të moslejojë varrosjen e të bijës. "Dyshoj te taksisti"



Jorgo Anagnosti

## Ngjarja

NIKOLETA KOVAÇI  
TIRANË

**N**ga Saranda i ka kërkuar policisë së Janinës të ndërhynte dhe të mos lejonte varrimin e të bijës, cermoni që do të kryhej në orën 15.00 të së djeshmes. Ndërsa po nga Saranda, burri, të cilin dy ditë më parë, në rrethana tërësisht misterioze, i ndërroi jetë e bija, 16 vjeçe, me të cilën, në fakt, ishte ndarë që prej 10 vitesh, ka akuzuar të dashurin e ish-gruas se i ka vranë vajzën. Historia e

vdekjes së misterioze nis po në Sarandë, ku u bë me dije ditën e diel se Kostandina Anagnosti kishte ndërruar jetë pasi kishte kryer një vizitë tek një dentist në Sarandë. Madje u tha se vajza kishte vdekur në taksì, në zonën e 'Qafë Botës' teksa kthehej për tek nëna e saj në Janinë. Mirëpo ka qenë i ati, i cili ditën e djeshme ka hedhur dritë mbi taksistin që po transportonte të bijën si dhe mbi jetën e familjes së tij, njëkohësisht ka akuzuar publikisht pikërisht 'taksistin' për vdekjen e të bijës, pasi ai pretendon se taksisti mund ta ketë përdhunuar vajzën e tij. Jorgo Anagnosti, nuk ka pranuar ekspertimin mjeko-ligjor të Sarandës, që përcaktojnë se vdekja ka ardhur për shkak natyrale.

Babai që është ndarë me nënën e viktimës shumë vite më parë, ka kërkuar nga organet kompetente të vendit fqinj të kryejnë një tjetër ekspertizë për trupin e pajetë të të bijës.

## PRETENDIMI I BABABIT

Ndërsa prokuroria e Janinës ka urdhëruar ndalimin e ceremonisë mortore e cila ishte parashikuar të zhvillohej dje, Jorgo Anagnosti ka rrefyer të gjitha dyshimet e tij mbi vdekjen e vajzës, Kostandina. Jorgo Anagnosti ka treguar se kur është futur në morgun e Sarandës ka dalluar shenja në trupin e vajzës së tij. "Pashë vajzën në gjendje jo normale. Pashë njolla nëpër duar. Dua ri-ekspertizë. Mësova se ish-bashkëshortja ime

## I ati:

Dua ri-ekspertizë. Mësova se ish-bashkëshortja ime ka vendosur ta varrosë vajzën në Janinë

ka vendosur ta varrosë vajzën në Janinë. Do nisem sonte për në Janinë dhe kam i kërkuar Prokurorisë së Janinës të mos lejojë varrosjen e vajzës deri sa të bëhet një tjetër ekspertizë nga mjekët atje. Për këtë do

të këmbëngul me forcë." Ai akuzon bashkëshortesin e ish-gruas së tij si përgjegjës për vdekjen e vajzës: "Dyshoj se diçka ka ndodhur. Besoj se ai e ka fajin pasi vajza nuk ka patur probleme nga vizita te dentisti".

## LAJME shkurt

Tritol mjetit luksoz në Tiranë, pronarja: S' kam konflikte

— Një mjet është hedhur në erë orëve të para të së djeshmes në afërsi të ish-Parkut të Autobusëve në Tiranë. Shpërthimi i fuqishëm ka tronditur banorët e zonës, ndërsa policia që ka shkuar në vendin e ngjarjes ka nisur menjëherë hetimet. Sipas të dhënave, u bë me dije se mjeti i shënjestruar, BMW X5, i përket një shtetaseje e cila ka mohuar në mënyrë kategorike të ketë konflikte me ndonjë njeri. Policia ka saktësuar se nuk është bërë e mundur të zbulohen gjurmë autorësh.



Durrës, brenda një ore denoncohet zhdukja e dy femrave

— Policia e Durrësit ka nisur verifikimet në lidhje me largimin nga banesa të dy femrave, denoncimi për këtë fakt ka ardhur nga familjarët e tyre. Sipas të dhënave që vijnë nga policia e qytetit bregdetar mësohet se një banor i Romanatit ka denoncuar zhdukjen e vajzës 21 vjeçe. Policia pas verifikimit, ka mësuar se ajo është larguar nga banesa dy ditë më parë. Gjithashtu saktësohet se një i ri nga Hamallajt, ka denoncuar zhdukjen e të fejuarës së tij, 15 vjeçe.

## Arrestimi

TIRANË

**N**jë 32-vjeçare shqiptare, e njohur me pseudonimet "Princesha Eva" dhe "Dama e Bardhë" është vënë në pranga nga policia italiane, pasi akuzohet për trafik droge dhe prostitucion. Eva Preka ishte shpallur në kërkim nga autoritetet italiane në vitin 2013, pasi ndaj saj ishte lëshuar edhe një vendim dënimi për një sërë akuzash të ngritura nga drejtësia e vendit fqinj. 32-vjeçarja është dënuar në vitin 2011 me tre vite burg nga drejtësia italiane, pasi iu sekuestrua në shtëpinë e saj në Sanremo një sasi prej 400 kilogram heroinë. Heroina kishte ardhur nga Holanda dhe hetimet aso kohe zbuluan faktin se lënda do të shpërndahet në Itali. Eva, po ashtu, akuzohet si prostitutë lukse dhe si organizatore e një rrjeti vajzash "shoqërimi", që sipas medias italiane konsideroheshin prostituta lukse, kryesisht me femra rumune nga 19 deri 28 vjeçe. Gjatë kësaj kohe, "Princesha Eva" ka mundur t'i fshihet policisë italiane, por ato që e kanë tradhtuar kanë qenë fotot. Eva kishte shpërndarë në rrjetet sociale foto të sajat "selfie" të bëra

# 'Princesha e kokainës' prangoset në Javën e Modës

Eva Preka, 32 vjeçe, ishte e dënuar për drogë dhe prostitucion



Eva Preka

## Identifikimi

Pas analizës daktiloskopike, policia italiane identifikoi përfundimisht Evën. Ajo u arrestua dhe u dërgua në burgun e San Vitores

gjatë "Jet-set Milano, Fashion Èeek" me personazhe të shquara të Shoë-bizit italian. Pikërisht këto foto e tradh-

tuan "Princeshë Evën", ku ishin karabinierët më pas që e vunë nën mbikëqytje. Kur e arrestuan, ajo u përpoq t'i mashtronte karabinierët duke u treguar një pasaportë false shqiptare. Pas analizës daktiloskopike, policia italiane identifikoi përfundimisht Evën. Ajo u arrestua dhe u dërgua në burgun e San Vitores. Shqiptarja është e skeduar prej vitesh në Itali, ndërsa ajo ka qëndruar atje edhe pasi drejtësia italiane e kishte të kërkuar ndërkom-

## Zbulimi

Si u identifikua shqiptarja nga 'selfi-të'

— Kanë qenë disa 'selfi' që kishte bërë me VIP-at italianë, provat që kanë "tradhtuar" shqiptaren 32 vjeçe, e cila njihet si "eskortë", ose shoqëruese për kënaqësi seksuale, teksa prej një viti ishte shpallur në kërkim. Këtë javë në Milano ishte java e modës dhe Eva Preka, që njihet edhe si "Dama e Bardhë", apo "Princesha Eva", kishte shkrepur disa foto me personazhe të njohur dhe i kishte hedhur në rrjetet sociale. Epitelet me të cilat është njësuar në mediat italiane shqiptarja, mësohet se i mori në vitin 2010, pasi u arrestua në Sanremo. Nga hetimet rezultoi se "Dama e Bardhë", këto kohë është endur midis Romës dhe Milanos, në ndjekje të klientëve të pasur, në restorantet më të mira dhe hotele në të dyja qytetet. Fillimisht, ajo ishte njohur nga një prej hetuesve, pak çaste para arrestimit, teksa vështronte me zell një butik dhe Eva në fillim e ngatërroi me një klient të mundshëm. Por kur ai po afrohej për ta arrestuar, ajo kishte buzëqeshur dhe i kishte thënë se ishte pikërisht ajo që ai kërkonte.

bëtarisht për akuzat e rënda. Preka, mendohet se ishte koka e një organizate krimi-

nale që merrej me trafikun e heroinës nga Holanda në drejtim të Italisë.

Shkëlzen Kala nga Synej i Kavajës gjendet i vranë në objektin që ruante

# Ekzekutohet në gjumë, me katër plumba, roja 25-vjeçar

## Familja: Djalin na e vranë njerëzit e ish-të fejuarës

### RRËFIMI

“Vëllain ma vranë njerëzit e ish-të dashurës”

— Viktima e ekzekutimit në Synei të Kavajës mësohet se ka qenë i fejuar me një vajzë nga zona e tij, por pas marrëveshjeve me familjen e vajzës, kjo e fundit është ndarë me Shkëlzenin. Vajza mësohet se është fejuar me një tjetër person, ndërkohë që vetë viktima e djeshme, disa muaj më parë është kronfrontuar fizikisht me vëllain e ish-të fejuarës. Detajet i ka dhënë vëllai i tij, Qazim Kala, që sipas tij dyshimet kryesore për vrasjen e Shkëlzenit i hedh pikërisht mbi familjen e vajzës. Policia ka dokumentuar dëshminë e familjarëve të viktimës, ndërsa janë marrë në pyetje edhe disa prej familjarëve të vajzës, që akuzohen nga familja Kala. Njëkohësisht policia dhe prokuroria janë fokusuar edhe në dy pista të tjera që kanë të bëjnë me një konflikt të disa kohëve më parë të viktimës, si dhe të ndonjë hakmarrjeje të mundshme, për faktin se ai dhe të afërmit të tij dyshohet se janë marrë edhe me trafik.

**NIKOLETA KOVAÇI**  
TIRANË

**Ë**shtë larguar nga shtëpia e tij në orët e vona të së dielës, ndërsa ka marrë shërbimin e rojes në një ndërtesë në Synej të Kavajës. Afër mesnatës, banorë të zonës kanë dëgjuar të shtëna armësh, por pa kuptuar se ku ishte vendi i krismave. Banorët kanë lajmëruar policinë por zbulimi i krimit të rëndë ka ndodhur vetëm në të gdhirë, ndërsa kanë qenë sërisht banorët e zonës të cilët kanë parë se në godinën që ruhej nga 25-vjeçari Shkëlzen Kala ishte xhami i dritares i thyer me plumb. Atëherë banorët kanë shtyrë derën dhe e kanë gjetur të vdekur në afërsi të portës. Policia ka mbërritur në vendin e ngjarjes, ka bërë kqyrjen e vendit të krimit dhe ka nisur menjëherë punën për të zbuluar shkaqet dhe autorët e vrasjes. Sipas të dhënave të para, saktësohet se familjarët kanë një person të dyshuar si ekzekutori i mundshëm i djalit të tyre, ndërkohë policia, përveç dyshimit të familjes, po heton edhe mbi të shkuarën e viktimës, pasi sipas tyre ai rezultoi si person me precedent të penal në fushën e vjedhjes dhe të trafikëve. Janë shoqëruar



VRASJA

### Ekzekutimi

Persona të paidentifikuar kanë ekzekutuar me katër plumba 25-vjeçarin Shkëlzen Kala në Synej të Kavajës. Policia dyshon se vrasja ka ndodhur pak pas mesnatës, ndërsa i riu u gjet i pajetë dhe në mëngjes

### Familja

Zbulimi i trupit të pajetë në objektin që ruante, ka bërë që familja Kala të akuzojë publikisht familjarët e ish-të fejuarës së tij, një lidhje që sipas tyre ishte prishur nga familja e vajzës.

### Hetimi

Policia e Kavajës është përqendruar në disa pista për të hedhur dritë mbi ekzekutimin e 25-vjeçarit Kala. Dyshimet janë përqendruar në pistën e hakmarrjes si dhe të konflikteve personale



Shkëlzen Kala



Objekti në të cilin u qëllua 25-vjeçari

disa persona, ndërsa janë dokumentuar dëshmi të shumta në lidhje me ekzekutimin e rojes.

**VERSIONI I POLICISË**  
Pas këqyrjes së vendit të

ngjarjes ekspertët kriminalistikë kanë hedhur dritë mbi mënyrën se si është kryer vrasja e 25-vjeçarit Shkëlzen Kala. Referuar të dhënave që vijnë nga policia e Kavajës saktësohet se i riu është

qëlluar nga dritarja dhe në atë çast dyshohet se ka qenë në gjumë, pasi janë gjetur gjurmë gjaku në një shtrat që ndodhet pranë dritares së dëmtuar. Pasi është qëlluar në shtrat, Kala, mendohet të

jetë ngritur dhe të jetë nisur drejt derës, për të bërë të mundur daljen përjashta për t'iu shpëtuar agresorëve. Dyshohet se pikërisht në derë, iu kanë dhënë edhe dy plumba të tjerë duke e lënë të vdekur në vend.

**VIDEO/ RRËFIMET PËR VRASJEN E 25-VJEÇARIT**

Për të parë videon në smartphonin tuaj skanoni QR CODE me APP të AIREPORT që shkarkohet falas

### KRUJË

## Plumba 3 kushërinjve në mortin e të atit të tyre

I arrestuari për kultivues droge, plagos kushërinjtë Çangu

**K**onfliktet për drogën duket se nuk ndalojnë hakmarrjen as në cermoni mortore, e aq më tepër as mes kushërinjve. Përplasja për një sasi lënde narkotike, që në fakt ende nuk është përcaktuar nëse ka të bëjë me trafik apo me një parcelë të zbuluar nga policia në verë, për pak sa nuk është kthyer në një masakër e trefishtë në fshatin Nikël të Krujës. Ngjarja ndodhi mesditën e djeshme, teksa tri shënjestrat e kushërinjve të tyre, sapo kishin varrosur të atin, kur janë qëlluar me armë nga kushërinji që iu kishte ardhur për ngushëllim. Arma mësohet se ka qenë një çifte, ndërsa autori, pas plagosjes së trefishtë është munduar të largohet në drejtim të paditur. Rreth 3 km larg vendit të ngjarjes është bërë e mundur të ndalohet, ndërsa tre vëllezërit, kushërinj të tij, janë nisur në drejtim të Spitalit Ushtarak në Tiranë.

### KONFLIKTI

Vëllezërit Ali, Dashamir dhe Bajram Çangu pas cermonisë mortore të babait të tyre mësohet se janë



### Policia:

## Shkak i plagosjes, pazaret për drogën

— Policia e Durrësit bëri me dije mbrëmjen e djeshme se dy prej protagonistëve, autori dhe njëri nga të plagosurit janë persona të arrestuar më parë për kultivim dhe trafik droge. Të njëjtat burime treguan se hetimi është përqendruar pikërisht në prishjen e pazareve për një sasi droge, por ende nuk është përcaktuar konkretisht shkaku i sherrit mes kushërinjsh. Saktësohet se autori i plagosjes së trefishtë është gjetur i plagosur me mjete të forta, çka rrit dyshimet se ai mund të jetë dhunuar më parë nga tre të plagosurit.

konfliktuar me një kushërinin e tyre që kishte ardhur për ngushëllim në shtëpi. Policia nuk bën me dije detajet e debatit mes kushërinjsh, por saktësohet se Estref Çangu, 48 vjeç, pas sherrit me tre vëllezërit ka marrë një armë gjahu dhe ka qëlluar mbi ta. Referuar të dhënave të policisë mësohet se Estrefi është arrestuar në fillim të gushtit të këtij viti, pasi rezultoi se kishte kultivuar kanabis. Por ai u la i lirë pas 48 orësh, ndërsa kushërinji i tij, një prej personave të plagosur, është arrestuar nga një operacion i policisë së Durrësit me 9 shtator të po këtij viti. Sipas të dhënave, Bajram Çangu, u prangos në afërsi të aksit rrugor Fushë-Krujë-Durrës, ndërsa shoqëronte një furgon nxënësisht, me të cilin transportohej lëndë narkotike, kanabis sativa. Në fakt, Çangut nuk iu gjet asgjë kompromentuese në makinën e tij, por ai u detyrua si shoqëruar i mjetit transportues, brenda të cilit u prangosën dy persona. Bajram Çangu u lirua për mungesë provash pas 30 ditësh.





# Pa njohur krimet, s'ka marrëdhënie normale



NGA GJAKË DABAJ

vijon nga faqja 1

Kur kemi të bëjmë me një shtet kriminal, problemi është, sigurisht, më i ndërlikuar, por, gjithsesi, pranimi i krimeve mbetet çelësi i zhvillimeve të mëtejshme. Vetë shteti i kriminalizuar nuk mund ta vazhdojë rrugën normale të jetës, nëse nuk çlirohet disi nga barra e krimeve që ka kryer, dhe rruga e vetme për t'u çliuar është: pranimi publik i fajit dhe shprehja e gatishmërisë për të paguar dëmshpërblimet.

Në rastin e marrëdhënieve shqiptaro-serbe, pranimi i krimeve nga ana e Serbisë, nga njëra anë, krijon kushte për një katarsis kombëtar brenda kombit serb; nga ana tjetër, i jep arsye kombit shqiptar që të mos ndjehet i poshtëruar.

I kemi thënë këto gjëra edhe më parë (jo vetëm unë, por edhe

të tjerë), sa herë që është folur për bisedime me Serbinë, por, duke mos u marrë kjo punë shtetërisht në dorë, sa herë që janë bërë bisedime, pa e vënë si kusht pranimin e krimeve, serbët kanë vazhduar të bëjnë manovra politike të ulta dhe poshtëruese ndaj shqiptarëve. Kështu ka ndodhur në bisedimet Kosovë-Serbi, kështu ndodhi edhe me vizitën e kryeministrit të Republikës së Shqipërisë në Beograd. Puna arrin deri aty, sa ata po mundohen ta paraqesin si „fyerje“ faktin që Edi Rama „guxoi e kërkoi“ „mu në mes të Beogradit“ që Serbia ta njohë Republikën e Kosovës. U sollën në mënyrë të ulët, njëlloj si janë sjellë edhe ndaj lojtarëve tanë, veçse jo me britma e ulurima dhe jo me gurë e me stola.

Edi Rama bëri të njëjtën gjë si dhe ekipi ynë i futbollit: U përpoq të luajë mirë. Serbët bënë të njëjtën gjë: U sollën ndaj kryeministrit tonë siç janë sjellë para një muaji me ekipin tonë të futbollit. Madje, vetë A. Vuçiqi shprehu keqardhjen që s'kish marrë dot një shkop për ta goditur Edi Ramën.

Ky është çmimi, me të cilin shteti shqiptar dhe kombi shqiptar po e paguajnë moskërkimin që Serbia t'i njohë krimet që ka bërë ndaj nesh. Varet tani nëse „gjuqi“ ndaj kësaj vizite do të silltë prapë siç u suall UEFA ndaj ekipit tonë. Dhe duket se pikërisht ashtu po sillen. Ndërsa Platania i sportit i dënoi thuasje njësoj të dyja palët, Platania i politikës po i lavdëron njësoj të

dyja palët. Platania i politikës, dmth Evropa Perëndimore, nuk po i thotë Vuçiqi: „Mirë të tha Edi Rama! Serbia duhet ta njohë Republikën e Kosovës“ Rusia i tha Serbisë: „Mos e njih Republikën e Kosovës!“ BE-ja nuk po i thotë Serbisë: „Njihë Republikën e Kosovës!“

Presidenti i atij shteti dhe kryetarja e parlamentit të Republikës së Serbisë nuk e pritën kryeministrin tonë. Kryeministri i Serbisë nuk i dha as dorën kryeministrit tonë dhe u shtir sikur ndihje „i fyer e i provokuar“. Ky është çmimi që paguajmë ne, në vend që të paguajmë ata.

Fundja, ç'është Edi Rama, që Vuçiqi ta quante „provokim“? Tha që Republika e Serbisë duhet ta njohë Republikën e Kosovës. Tha fare pak në krahasim me ç'duhej të thoshte dhe, megjithatë, ata tentuan t'ia mbyllin gojën, duke na fyer ne për të milionitë herë me shprehjen „Kosova është Serbi“. Ky është çmimi që paguajmë!

Kur të hapim albumin e Nusret Pllanës dhe një mori albumesh, statistikash e dokumentesh të tjerë, a duket sikur „Kosova është Serbi“?! A vrasin popullin e vet serbët në Kosovë?! Si qenka Serbi një vend që masakrohet prej serbëve?!

A. Vuçiqi i fyeu edhe shqiptarët e Anamoravës, duke thënë që ata jetojnë „në tokën serbe“, në një kohë kur gjithkush e di që shqiptarët e Preshevës, Bujanovcit etj. jetojnë prej shekujsh në tokën e vet. Si do t'u vinte serbëve nëse ne do të thoshim: „Serbia është Shqipëri“, duke

aluduar që Singiduni (Beogradi) dhe Naissusi (Nishi) kanë qenë qytete të lirisë dhe të bënim masakra në emër të kësaj ideje?!

Në çdo hap të asaj të ashtuquajturës mikpritje kishte fyerje, të natyrës që vetëm serbët shovinistë dinë t'i bëjnë. Në konferencën e shtypit kishin vënë vetëm një mikrofon, njësoj siç ndodh në disa festivale, ku organizuesit janë vajtimisht të varfër. Kur u këndua himni shqiptar, ku duhej të ishte dhe ku ishte vënë flamuri shqiptar? Në atë të quajturin „forum për marrëdhëniet etnike në Ballkan“, kryeministrin tonë e kishin ulur te një tavolinë, që mezi i merrte tre vetet dhe krejtë salla, ku ishin grumbulluar nja 200 njerëz, u ngjante vatrave të kulturës në kooperativat tona, ku kooperativistët mblidheshin për të bërë analizat mujore e vjetore.

Për çfarë u fol në atë „forum“?! S'u fol thuasje për asgjë, në një kohë kur, lidhur me marrëdhëniet ndëretnike në gadishullin tonë, ka qindra probleme tepër të rëndësishëm, madje jetikë për t'u trajtuar dhe analizuar. Midis tjerash, aty e kish vendin për t'u përmendur e trajtuar pikërisht tema e krimeve të shtetit serb mbi kombin shqiptar.

Kur flasim për problemin e njohjes së krimeve, ia vlen edhe të kthehemi në kohë. Më 1924-n, as që mund të pyetet pse A. Zogu nuk foli për krimet që kishin bërë serbët ndaj shqiptarëve. Nuk mund të pyetet kështu, sepse ai shkoi atëherë në Beograd, jo si një burrë shteti, por

si një qyqar. Shkoi për të kërkuar ndihmë, që të rrezonte Fan Nolin! Faqja e zezë, e tija dhe e jona! Por as E. Hoxha në vitin 1946 nuk foli për krimet që kishin bërë komunistët jugosllavë ndaj shqiptarëve, gjithandaj nëpër ato pjesë të Shqipërisë, që nga Zajazi i Kërçovës e deri në Tivar. Prandaj, kur Enveri i kërkoi Titos që Kosova t'i bashkohej Republikës Popullore të Shqipërisë, Titoja ia mbylli gojën me një fjali të vetme: „Jam dakord, por ç't'i bëjmë Serbisë, që nuk është dakord!“

A. Vuçiqi iu përgjigj Ramës edhe më keq se Titoja Enverit: „Kosova është Serbi!“, shprehje, të cilën ai do ta përdorë edhe në Tiranë, nëse nuk do t'i dilet përpara një të tillë skandali, i cili do ta asgjësonte krejtë punën e mirë që Edi Rama ka bërë në Beograd e në Preshevë. Ç'dobi ka kërkesa e Edi Ramës në Beograd, që Serbia ta njohë Kosovën, kur A. Vuçiqi do të vijë nesër në Tiranë dhe do të na thotë përsëri: „Kosova është Serbi!“ Ai do të thotë ashtu, kurse BE-ja do të gëzohet që, më në fund, „u rregulluan edhe punët e Ballkanit“.

Që të tri vizitat që i përmenda më lart i kanë shkaqet e vet pikërisht te fakti që shteti ynë, në atë kohë, kurse sot dy shtetet tanë, nuk e kapin problemin e marrëdhënieve me sllavët (edhe me grekët) nga themeli: Të sqarohet njëherë botërisht problemi i krimeve, që ata shtete kanë kryer ndaj kombit tonë! Nuk kemi shkuar ne në tokat e tyre, por kanë ardhur ata në tokat tona dhe krimet i kanë kryer ndaj popullsisë civile, ndaj fëmijëve e ndaj grave tona!

E gjithë e keqja qëndron te boshllëku që kemi ne në kushtetutet tona. Sepse kuptohet që një kryeministër nuk mund të shkojë e t'u kërkojë fqinjëve: „Njihini krimet që kemi kryer! Pranojini krimet që kemi kryer!“ Unë, dy ditë para se të shkonte Edi Rama në Beograd, thashë që ai duhej të merrte me vete albumin e Nusret Pllanës. Thashë kështu, sepse e dija si do të sillen serbët. Por, në të vërtetë, punët duhen bërë ndryshe. Duhet paraprakisht të shtetërisht të trajtohet ky problem kaq i madh dhe t'i gjendet një zgjidhje, para se një kryepushtetar yni të shkojë për vizitë te kryerësit e qindra mijëra krimeve.

Ne nuk kemi strategji, as shtetërore, as kombëtare për mbrojtjen e jetës së shqiptarit. Shihni SHBA si ruan dhe si mbron jetën e një shtetasi të vet! Ndërkaq, ne, shqiptarët, e kemi një ligj familjar, që vrasësin eventual të një pjesëtarit të familjes, o duhet ta dënojë gjyq, ose e dënon vetë familja, qoftë edhe me kosto shumë të lartë. Dy shtetet tanë, paradoksalisht, nuk i kanë të përcaktuar në kushtetutet e veta, as mbrojtjen e dinjitetit, as ruajtjen e jetës së shqiptarëve.

Duhet, pra, të merren sa më parë masa në fushën e legjislatcionit, përndryshe, çdo përpjekje për marrëdhënie normale me fqinjët, jashtë këtyri parimi themelor, do të përfundojë, si në dënimin tonë, ashtu edhe në dënimin e vetë shteteve fqinjë me ne, të cilët, pa këtë „terapi“, kurrë nuk do të mund të shërohen nga megalomania e tyre, krenjtë e paarsyeshme. Dhe, për të gjitha këto, nuk duhet të dëgjojmë fort ç'na thonë të huajt, sepse atyre nuk u dhemb kurrizit ynë...


## » PERFORMANCA



**TRUPA HUNGAREZET**  
“Hodworks” shfaq performancën koreografike sot në orën 19.00 në Galerinë Kombëtare të Arteve. Vallëzimi përqendrohet në lëvizjet e trupit lakuriq të katër artistëve: Cuhorka, Garai, Molnár e Canabarro.

# Trupa hungareze “Hodworks” performon lakuriq

Shfaqet performanca koreografike “Agim” (Dawn) e Adrienn Hod. Fituese e çmimit “Rudolf Lábán” 2013



**“La Bohème”**  
Shfaqet në Teatrin Kombëtar të Operas dhe Baletit

— “La Bohème” nga Giacomo Puccini është opera me 4 akte, e cila do të shfaqet në skenën e Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit në datat 20/22 dhe 24 nëntor 2014 ora 19:00. Kjo vepër që herën e fundit është vendosur në skenë në vitin 2003, kësaj here premtom dhe vjen ndryshe. Në regjinë e Andrea DeManicor, skenografinë dhe kostumet e Shaban Hysës, dirigjimin e Daniela Candiottos, dirigjentit të korit Dritan Lumshi dhe drejtueses së korit të fëmijëve, Irida Begës, interpretuesit s,i tenori Cristian Ricci (në rolin e (Rodolfo), soprano Alisa Kastroshi dhe Evis Mula (në rolin e Mimì), baritoni Armando Likaj (në rolin e Marcellos), sopranoja Dorina Selimaj (në rolin e Mussetës), baritoni Ogert Islami (në rolin e Schuarnard), bass baritoni Enrico Marchesini (në rolin e Collin), bass baritoni Sidrit Bejleri (në rolin e Benoit) dhe bas baritoni Sokol Hidërsha (në rolin e Alcindoros), do ta interpretojnë veprën në shoqërimin e Orkestrës Simfonike, Korit të TKOB-së, si dhe korit të liceut artistik. Me anën e kësaj pjesë, të pranishmit në sallë do të kenë mundësinë të njohin dashurinë e madhe të Mimisë dhe Rodolfo, e cila vdes e re bashkë me protagonisten kryesore dhe në antitezë do të jetë Musseta dhe Marcello, të cilët luajnë me dashurinë e tyre.

**DHURATA HAMZAI**  
TIRANE

**K**atër valltarë me trupin lakuriq do të performojnë sot në orën 19.00 në Galerinë Kombëtare të Arteve në Tiranë; të përgatitur nga Adrienn Hod, një nga zërat më të rëndësishëm të koreografisë bashkëkohore të Hungarisë. Produksioni më i ri i performancës koreografike “Agim” (Dawn) i trupës “Hodworks”, që do të shfaqet sot, përqendrohet në trupin lakuriq. Sipas konceptit koreografik të Adrienn Hod, në këtë performancë trupi i zhveshur shpallset si një peizazh, konturuar nga përshkrimet e muskujve, rrugët e venave, struktura e lëkurës, rrudhat dhe linjat e saj. Koreografia sistematikisht dhe pa sentimentalizëm, fokusohet në aspektet anatomiko-mekanike të natyrës njerëzore animalistike. E vlerësuar si ‘performanca më e jashtëzakonshme bashkëkohore hungareze’ për vitin 2013, shfaqja e saj në Galerinë Kombëtare të Arteve do të jepet vetëm për një natë. Kjo performancë është edhe pjesë e edicionit të 9-të të Albania Dance Meeting Festival, që organizohet në Shqipëri nga Gjergj Prevazi. Premiera e performancës “Agim”, (Dawn), produksioni më i fundit i trupës ndërkombëtare Hodworks është fituese e Çmimit “Rudolf Lábán”, me motivacionin si “performanca më e jashtëzakonshme bashkëkohore hungareze” për vitin 2013. Adrienn Hód, këtë pjesë të guximshme dhe radikale e përshkruan si një vepër arti “që kërkon një nivel të jashtëzakonshëm vetëdije, force dhe ndjeshmërie nga interpretuesit”. Dhe këtë pretendim koreografik, kritika pohon se e ka arritur duke krijuar një vallëzim impresionues me artistët Emese Cuhorka, Júlia Garai, Csaba Molnár e Marcio Canabarro. Muzika është e Zoltán Mizesi dhe ndriçimi është realizuar nga Kata Dézsi dhe Coproducenti Trafo (Budapest). Trupa hungareze “Hodworks” mbledh krijues të ndjeshëm, proaktivë dhe vizionarë që punojnë sot me meta-toda krijuese dhe të përqendruara. Ata përqendrohen në trupin e nje-



**NË FOTO:** Pjesë nga performanca koreografike “Agim” (Dawn) e trupës hungareze “Hodworks”

riut, të çliruar nga kufijtë, skenat apo butaforitë. Vepër e kësaj trupe marrin gjithmonë drejtime të reja dhe progresive dhe janë rezultat i hulumtimeve komplekse bazuar tek improvizimi, i cili shfaqet në

formë rreptësisht të strukturuar në skenë. Pjesët e tyre stimulojnë shpirtin dhe shqisat e publikut dhe i ftojnë të gjithë t'i hapen të panjohurës. Trupa Hodworks u themelua nga koreografi hungarez

Adrienn Hód në vitin 2007. Përveç anëtarëve të përhershëm, kjo kompani ndërkombëtare me bazë në Budapest punon me artistë të ftuar nga zhanre të ndryshme të artit. Adrienn Hód është një nga zërat më të rëndësishëm në të rinj të koreografisë bashkëkohore të Hungarisë. Koreografia e Adrienn Hod është një bashkëprodhim me Trafo, Shtëpia e Arteve Bashkëkohore, dhe është mbështetur nga Ministria e Burimeve Njerëzore e Hungarisë, Fondi Kombëtar i Kulturës dhe prej disa prej fondacioneve kulturore, ku falë mbështetjes ka dhënë shumë premiera dhe është bërë e famshme nëpër Europë.

### Konferenca

## Ministria e Kulturës përkujton 70- vjetorin e vdekjes së Mary Edith Durham-it

**N**ë 70-vjetorin e vdekjes së Mary Edith Durham, udhëtares, artistes, dhe shkrihtarë britanike e famshme për shkrimet e saj antropologjike në trojet shqiptare, në fund të shekullit të XIX dhe fillim të shekullit të XX, Ministria e Kulturës njofton se do të nderojë figurën e saj me një konferencë shkencore në sallën “Tefta Tashko Koço” paraditen e së martës më 18 nëntor. Me pjesëmarrjen e studiuesve dhe profesorëve si Elizabeth Gowing, David Hosaflook, prof.dr. Ferit Duka, prof.dr. Xhevat Lloshi, prof.dr. Mark Tirta, dr. Shpend Bengu, kumtesat e mbajtura do të referojnë mbi kontributet madhore të Edith Durham-it në lidhje me shkrimet mbi tolerancën fetare në Shqipëri, kontributet në çështjen e gjuhës shqipe, antropologji, etj. Njohja e saj për



shqiptarët vazhdon të jetë bindëse edhe sot, si një shekull më parë. Disa nga vlerësimet e saj pwr shqiptarët janë: “Të gjithë shoqëruesit e mi kanë qenë shqiptarë.”; “Për durimin, urtësinë dhe qëndrueshmërinë e tyre nuk kam fjalë më të lartë lavdërimi për ta. Ata nuk janë shtazë ashtu siç i kanë përshkruar disa...”; “Të them të drejtën ata janë shumë të mençur, megjithëse janë të egër. Por që janë të egër, kanë qenë të detruar sepse kështu e kanë ruajtur larinë”; Kur ata të mos jenë më të detruar që të mbeten të shkëputur nga bota, atëherë ata do të zgjohej dhe do të shihet fuqia e tyre...Siguroj ata janë Bismarkë, Bismarkë të vërtetë. Dikur ata do të kërkojnë dhe Europa do të jetë e detruar t’ua japë atë që do të kërkojnë!” (Edith Durham, Brenga e Ballkanit).



## » EKSPozITA

# Fate Velaj, deklaratë mirënjohjeje nga Bashkia e Cleveland-it

Këshilltari i kryeministrit çeli në SHBA ekspozitën fotografike "Shqipëria-e parë ndryshe"

FLORA NIKOLLA  
TIRANË

Fate Velaj, këshilltari të kryeministrit Edi Rama për Diplomacinë Kulturore dhe Rilindjen Europiane, në prani të kryetarit të Bashkisë së Cleveland-it, Franklin Jackson, dhe anëtarëve të këtij këshilli, i është dhënë "Resolution of Welcome and recognition" (Deklarata e Mirënjohjes dhe Mirënjohjes). Deklarata i është dhënë me motivacionin se "Këshilli Bashkiak i Cleveland është krenar t'i thotë Fate Velaj, mirëseerdhe në Cleveland dhe t'i shprehë mirënjohjen për angazhimin e tij gjatë aktivitetit të titulluar "Arti për mirëson kohën". Kryetari i këshillit, Kevin Kelley, i dorëzoi titullin. Fate Velaj tha se: "unë nuk e di se kur ka ardhur shqiptari i parë në Cleveland, por, di se aty nga vitet 1876, në SHBA do të shkelle i pari shqiptar dhe, nga thellësia e bindjes sime të plotë them se ai, do të kete shkelur me këmbën e mbarë dhe dorën në zemër këtu tek ju, në tokën e premtuar". Duke ju referuar ndihmës së Amerikës ndaj shqiptarëve dhe Shqipërisë, Velaj tha se, "ju keni bërë aq shumë për ne, sa që ne nuk do jemi kurrë në gjendje t'ju falënderojmë dhe ndoshta nuk është mirë të them se ju, se dini se ku bie tamam Shqipëria për të mos thënë se nuk e dini se ku i bie qyteti im Vlora apo Fieri ku, në çdo 4 korrik, në "Sheshin Europa", nën himnin e Amerikës dhe fjalëve "God bless America" ne ngremë flamurin tuaj si një shenjë respekti e dashurie për popullin amerikan, për vlerat themelare të njerëzimit që ai përfaqëson dhe për të gjithë ato vajza e djem shqiptarë që jetojnë e punojnë këtu, mes jush të cilët janë Shqipëria e vërtetë dhe mishërim i

vlerave të saj".

Gjatë kësaj vizite, Fate Velaj, i cili ndodhet në SHBA së bashku me Kryetarin e Bashkisë së Fierit Baftjar Zeqaj, zhvilloi disa takime të rëndësishme mes tyre dhe një takim me senatorin Sherrod Brown, të cilin e falënderoi për mbështetjen që SHBA i kanë dhënë Shqipërisë gjatë gjithë historisë dhe e informoi mbi zhvillimet në Shqipëri dhe në

**VELAJ** i dorëzoi senatorit Sherrod Brown letrën që kryeministri Rama i dha për senatorin, ku e informonte mbi zhvillimet në Shqipëri, ato të bashkëpunimit në kuadër të angazhimeve të përbashkëta dhe e ftonte të vizitonte Shqipërinë



Fate Velaj gjatë ceremonisë

veçanti ato që kanë të bëjnë me rolin e Shqipërisë si faktor stabiliteti në rajonin e Ballkanit. Gjithashtu, Fate Velaj e informoi mbi angazhimet e Shqipërisë në "koalicionin kundër të keqes" siç janë ato në angazhimet në luftën kundër terrorizmit dhe ato në NATO dhe më pas, mbi vizitën e kryeministrit Rama që po atë ditë zhvillohet në Beograd. Velaj i bëri një panoramë të botës së hapur dhe pa paragjykimet e komplekse të politikës së re shqiptare të pas 23 qershorit.

Senatori Brown vlerësoi rolin e Shqipërisë, jo vetëm në rajon dhe u interesuesua të dinte më shumë mbi disa aspekte të veçanta të politikës së jashtme të Shqipërisë. Me këtë rast, Fate Velaj i dorëzoi të nderuarit senator Sherrod Brown

dhe letrën që kryeministri Rama i dha për senatorin, ku e informonte mbi zhvillimet në Shqipëri, ato të bashkëpunimit në kuadër të angazhimeve të përbashkëta si dhe e ftonte të vizitonte Shqipërinë në një kohë që për të do të ishte e favorshme. Fate Velaj, gjatë qëndrimit në Cleveland ka çelur ekspozitën fotografike "Shqipëria - e parë ndryshe" në bashkinë e këtij qyteti me pjesëmarrjen e figurave qendrore të kësaj bashkie ku ishte vendosur flamurin shqiptar dhe ai amerikan.

Miq amerikanë e shqiptarë që banojnë në SHBA vlerëuan 70 fotografite e paraqitura, një perzgjedhje e punëve të realizuara nga Fate Velaj dhe fotografëve Ardan Fezollari nga Pogradeci, Arben Allaj nga Fieri dhe Met Axhushi nga Vlora.

### 70-vjetori i Çlirimit

## Fëmijët e ushtarakëve festojnë me krijimtari në Ministrinë e Mbrojtjes

— Në kuadër të veprimtarive që po zhvillohen me rastin e 70-vjetorit të Çlirimit të Atdheut, fëmijët e ushtarakëve nën drejtimin e Qendrës së Kulturës, Mediave, Botimeve, Muzeut dhe Shtëpive të Pushimit të Ministrisë së Mbrojtjes organizuan dhe shfaqën spektaklin me një

tematikë të pasur të repertorit të këngëve të Luftës Nacional Çlirimtare si: "Malet me blerin mbuluar"; "Shqiponjat Partizane", etj si dhe recitime të poezive që nga periudha e rilindjes e deri në ditët tona. Fëmijët e ushtarakëve shpallën gjithashtu vlerat e krijimtarisë poetike, patriotike të autorëve tanë më të shquar. Drejtoresha e re e QKMBMSHP, Mirela

Roshi duke vlerësuar aktivitetin u shpreh se stafi që ajo drejton, për fëmijët e ushtarakëve edhe në të ardhmen do t'u krijojë atyre kushtet dhe mundësitë për zhvillimin e talenteve të tyre për të marrë pjesë edhe në spektakle më të mëdha, si dhe duke konkur-

ruar edhe në edicione kombëtare në raste festash e ngjarjesh të ndryshme kulturore. Në vijim ajo theksoi se "Forcat e Armatosura janë një forcë e madhe dhe kanë prurje të tilla që përbushin dëshirat e fëmijëve dhe familjeve tona kur punojnë së bashku", tha Roshi.

Në përfundim të fjalës së saj Roshi u shpreh se fëmijët në këtë skenë përbëjnë vazhdimësinë e të gjithë atyre artistëve që me të vërtetë FA kanë krijuar ndër vite. Ky spektakël u realizua edhe me bashkëpunimin e Qendrës së Fëmijëve të Tiranës, të cilët me pjesët e valleve tiranase dhe të Tropojës i dhanë ngjyra e dimensione më të larmishme, duke përcjellë në këtë mënyrë për të pranishmit emocione të veçanta. Dueti i këngëtarëve Kozma

Dushi dhe Redon Makashi, i shoqëruar nga kori i fëmijëve u prit me shumë duartrokitje. Koloriti muzikor interpretative i fëmijëve ishte një premtim. "Dua më shumë Shqipërinë", ishte pjesa që mbylli programin e këtij spektakli.

### Paulin Zefi:

## 'Zbulimet në Lezhë rrezik të mbulohen me beton'

— Gjatë punimeve që po kryhen në ndryshimin e qendrës së Lezhës, mure që i përkasin shekullit VI kanë dalë në dritë, por ato nuk ka marrë vëmendjen e duhur. Ndonëse ky mur i gjetur ka shërbyer si mur i qytetit të jashtëm të Lezhës, askush nuk është shqetësuar për këtë fakt. Ka mjaftuar vetëm ndërprerja e punimeve në këtë zonë dhe më pas do të mbushet me gurë dhe beton nga firma që po kryen punimet në këtë zonë. Përgjegjësi i Sektorit të Monumenteve të Kulturës në Lezhë, Paulin Zefi, kërkon ndërhyrjen e Insitutit të Arkeologjisë për të studiuar vlerat që mbart ky mur me qëllim që mos të hidhet beton mbi të. Nëntoka në zonën ky po kryhen punime në sheshin para Bashkisë së Lezhës është një zonë arkeologjike, ku dëshmon për historinë 2400-vjeçare të Lezhës, por që kjo nuk ka shqetësuar intencionet përkatëse të cilët po heshtin përballë këtij fakti. Vetem tre ditë më parë në këtë zonë u gjet dhe një prehe që i përkiste Luftës së Dytë Botërore.



### Bruksel

## Nderohen 13 shkrimtarë me Çmimin European '14.

— Me ftesë të komisioneres Androulla Vassiliou, Komisionere e Arsimit, Kulturës, Shumëgjuhësisë dhe Rinisë në Komisionin Evropian, ministria e kulturës, Mirela Kumbaro, është ftuar të marrë sot pjesë në ceremoninë e dhënies së Çmimit Evropian për Letërsinë në Bruksel. Ben Blushi është autori shqiptar që ka fituar me veprën "Otello, Arapi i Vlorës". Ceremonia do të zhvillohet në Concert Noble, me prezencën e Komisionerit për Kulturën dhe Edukimin, si dhe anëtarëve të Parlamentit Evropian dhe përfaqësues të presidencës italiane në Bashkimin Evropian. Fituesit e vitit 2014 janë: Ben Blushi (Shqipëri), Milen Ruskov (Bulgari), Jan Némec (Republika Çeke), Makis Tsitas (Greqi), Oddný Eir (Islandë), Janis Jonevs (Letonia), Armin Öhrli (Lihtenshtejn), Pierre J. Mejlak (Maltë), Ognjen Spahić (Mali i Zi), Marente de Moor (Hollandë), Ugljesa Sajtinac (Serbi), Birgül Oğuz (Turqi) dhe Evie Eyld (Mbretëria e Bashkuar e Britanisë). Ndarja e çmimve bëhet sot më 18 nëntor në Bruksel.



NGA ARBEN DUKA

## BALADË

# Dr. Flori, shpirt i madh i rebelimit...

Ca vargje janë për lapidarë:  
"Kushdo që lind është një i vdekshëm,  
në jetë jemi kalimtarë,  
në vdekje jemi të përjetshëm!"

Krejt kalimtarë jemi në jetë,  
në vdekje jemi të përjetshëm,  
në Univer në të vërtetë,  
nuk ka pushtet më të pushtetshëm!..

Me miliarda janë korrur,  
jetë të mjera njerëzore,  
po ai drapër s'ka të lodhur,  
në ato duar djallëzore!

Dhe ato duar djallëzore,  
asnjë betejë s'kan' për të humbur,  
por arrogancën njerëzore,  
as frikë e vdekjes s'e ka mundur!

S'është kataklizma që na djeg,  
sot saktësisht këtë e dimë,  
po tmerr' i vdekjes na përndjek,  
në çdo sekondë që marrim frymë!

Ne themi si për ngushëllim,  
në gji të tuj na merr Bariu,  
po s'ka arsye e kuptim,  
t'i merret shpirti një të riu!..

Dot s'e kuptoj unë Zotin tim,  
që na ngul thika kraharorit,  
se s'kish arsye e kuptim,  
të fikje dritë e Doktor Florit!

Dhe zemra ime po më thotë,  
se s'është kjo një punë Zoti,  
kur miliona tek kjo Botë,  
na bëjnë hije kot së koti!

S'e dimë -kaq herët-pse na iku,  
ky shpirt i madh i rebelimit,  
qirinjti jeta pse ja fiku,  
as dhe në mes të rrugëtimit?!



I varfër sot më është fjalori,  
s'gjej dot një fjalë për ngushëllim,  
po e di mirë se Doktor Flori,  
nuk do të tretet në harrim!

Në zemër na qëlloi papritur,  
kjo vetëtimë e zezë e zisë,  
se një nga yjet më të ndritur,  
ju shua sot Shqipërisë!..

## SATIRË POLITIKE

# Ne jemi të majtë-or taj!..

Jemi një gazetë e majtë,  
po bëjmë dhe opozitë,  
por ne kundër qeverisë,  
nuk mund të shkruajmë çdo ditë!

Nëse gjithë opozitën,  
këtu do ta bëja unë,  
atëherë shtypi i djathtë,  
do mbetej krejt pa punë!

Nëse ti e bën kritikën,  
në vetëvehte një qëllim,  
po të qëmëtosh do gjuhë,  
dhe probleme pa mbarim!

Kritika për qeverinë,  
kam shkruar në të vërtetë,  
por unë jam një nga ata,  
që qeverinë e mbështet!

Kur shoh-mbas kritikës sime,  
se si lumturohen djajtë,  
në fakt s'ndihem dhe aq mirë,  
kur "ngas" qeverinë e majtë!

Dhe që në mendimin tim,  
të jem fare i përpiktë,  
kemi "miq" në internet,  
që janë në një kontradiktë!

Ata janë me ish-pushtetin,  
dhe aty e kanë besimin,  
ndaj dhe s'ju pëlqen një faqe,  
që majtas e ka drejtimin!

Dhe në s'ju pëlqen kjo faqe,  
për të ikur s'kanë pengesa,  
mund të lexojnë tek "RD-ja",  
dhe te Pesëdhjet e Pesa!

Domosdo që tek kjo faqe,  
do të mbeten anonimë,  
dhe ç'janë në të vërtetë,  
asnjëherë s'do ta dimë!

Kontrabandë në këtë faqe,  
na shajnë e na mallkojnë,  
dhe moderatorët tanë,  
asnjëherë s'i çensurojnë!

Po në fakt unë kam kërkuar,  
që këta mos publikohen,  
dhe kur janë të pafytyrë,  
s'ka arsye të ankohen!

Shtyp i lirë nuk do të thotë,  
jo kështu, drejt ta hajë,  
që këtu çdo lloj kopili,  
si t'i teket të na shajë!..

Tjetër gjë ti ke në zemër,  
edhe hiç s'e ke në mendë,  
atë qelbësirë pa emër,  
që të shan në shtëpinë tënde!

Kjo ka ndodhur dhe po ndodh,  
dhe do ndodhë e paskëtaj,  
ju kujtoj të pafytyrëve:  
"Ne jemi të majtë-or taj!"

Ne jemi të majtë-or taj,  
gjër në shkallën do-maxhore,  
anonimët këtu ndihen,  
tamam si në jetimore!

Në zenith të handikapit,  
këtu jini krejt të huaj,  
bëni mirë t'ja fusni vrapit,  
shkoni në halenë tuaj!

Nuk dua të më lexoni,  
ju të mënçur si veshgjati,  
nëse këtu do qëndroni,  
dilni nga anonimati!

Kam dëshirë që t'ju kujtoj,  
s'është kollaj të jesh njeri,  
një që më flet sy më sy!



Lirinë e fjalës së lirë,  
kot përdorni - o të gjorë,  
ata që pas gardhit fshihen,  
quhen veç provokatorë!

Liria ka triumfuar,  
ju mbetët tek bisht' i urës,  
ndaj më duken-ç'kini shkruar,  
si traktet e diktaturës!

Me ju është çdo fjalë kot,  
se jini në hall vërtet,  
që akoma edhe sot,  
kini frikë nga një poet?!..

Prapë së fundmi kujtoj,  
s'është kollaj të jesh njeri,  
në të rrallë kur ju lexoj,  
për ju ndjej veç neveri!

S'është kollaj të jesh njeri,  
aq më shumë njeri i mirë,  
e të jesh dhe luftëtar,  
është shumë më vështirë!

Unë kam qënë gush kur se zbardhi,  
nga raca e luftëtarëve,  
e ju që lehni pas gardhit,  
jini nga rracë e zagarëve!

## Këngë për Patriotin e Shquar Brahim Miho..

(Në kuadër të 70-vjetorit të Çlirimit)

Tej për tej të mori plumbi,  
po ti plumbin do duroje,  
nuk ike Brahim pëllumbi,  
jetove që të luftoje..

Luftove me trimëri,  
partizan me yll në ballë,  
dhe në jetë e histori,  
mbete një legjendë e gjallë.

Plumbi që të ra vërtetë,  
dot në luftë s'të mposhti ty,  
ta shkurttoi të shkretën jetë,  
se u fike shumë i ri.

Dyzet vite kanë kaluar,  
që kur ike vaj e lot,  
neve s'të kemi harruar,  
se ti na ke mbledhur sot.

Brahim-Patriot i Shquar,  
frymëzimi i rinisë,  
mbete një Yll i Pashuar,  
në ballin e Shqipërisë.

Të kujtojnë shamizezat,  
o Brahim-o trim-o trim,  
se ti na ke lënë për brezat,  
më të bukurin kujtim.


Si një dritë e vërtetë,  
ndriçon udhën nëpër brezat,  
asnjëherë në këtë jetë,  
të bardhën s'e nxin e zeza.



# » EKSKLUZIVE

**DOKUMENTI** i cili botohet i plotë sipas origjinalit që ruhet në AQSH, sjell edhe shumë detaje të tjera interesante, që zbardhin marrëdhënien e veçantë që ekzistonte mes Enver Hoxhës dhe Mehmet Shehut në vitet e luftës.

**NË FOTO:** Faksimile e letrës së Mehmet Shehut drejtuar Enver Hoxhës 16 nëntor 1944 dhe Mehmet Shehu gjatë viteve të luftës.



# Mehmet SHEHU

## Letra e që dëshmon marrëdhëniet me Hoxhën në Luftë

Çlirimi i Tiranës dhe gjithë aksioni i përshkruar nga Mehmet Shehu në letrën e 16 nëntorit 1944. "Faleminderit për ndihmën që i ke dhënë nënës dhe familjes time. I kam hequr tashmë dyshimet mikro-borgjeze që herë-herë kanë qënë fiksuar në trurin t'im deri në Kongresin e Përmetit kur biseduam bashkë..."

**ADMINIRA PEÇI**  
TIRANË


7 ovjet më vonë, nga dita kur u shkrua kjo letër e Mehmet Shehut drejtuar Enver Hoxhës me 16 nëntor 1944, dokumenti që po paraqesim merr një rëndësi të veçantë. Vetëm paragrafi i saj i fundit flet për luftimet rreth Tiranës dhe castet në prag të çlirimit të saj. Por edhe një paragraf i vetëm, në të cilin rreshton shifra, dhe detaje të imtësishe të planit të luftimeve për çlirimin e kryeqytetit. Dokumenti, i cili botohet i plotë sipas origjinalit që ruhet në AQSH, sjell edhe shumë detaje të tjera interesante, që zbardhin marrëdhënien e veçantë që ekzistonte mes Enver Hoxhës dhe Mehmet Shehut në vitet e luftës. Kjo letër vjen pas dy letrëkëmbimeve mes tyre, të periudhës nëntor 1943-prill 1944, komunikim, që dëshmonte një gjendje jo fort miqësore mes të dyve. Në njërin prej letrave Shehu i raportonte Hoxhës ngjarjen e bujshme të ekzekutimit të 65 ballistëve, ndërsa në përgjigjen e tij Hoxha e kritikonte dhe i bënte thirrje për të bërë kujdes e për të ruajtur figurën e tij si komandant. "Ke ekzekutuar 65 ballistë ky gjest e errëson tablonë. Ky ekzekutim është i tepëruar, pa vend dhe shumë i gabueshmë pse në vend që të na sjelli fitime,

na dëmton. Duhet të kemi parasysh se katundarët që ndodhen në çetat e Ballit janë elementa të pa fajshëm, të pa sqaruar dhe viktima...", i shkruante Hoxha Shehut në letrën e 5 nëntorit 1943. Ndërsa në prill 1944, Enver Hoxha vijon ta kritikojë komandantin e Brigadës së Parë Sulmuese Mehmet Shehun. "Nuk të lejohet më të shkoh në sulm përpara partizanëve për t'u dhënë shëmbëllën këtyre atje ku prezenca e jote s'është e domosdoshme. Vetëm kur Brigada të jetë në rezik të madh duhet të ndërtonohet personalisht... Ky është një urdhër që të jepet dhe që duhet të zbatohet përpiknisht, në qoftë se veprohet ndryshe do të jetë një mos bindje ndaj Partisë dhe ndaj Komitetit Qendror", i shkruan Enver Hoxha në letrën e 14 prillit 1944. Pas kësaj gjendjeje mes dy udhëheqësve, duket se raportet mes Shehut e Hoxhës kanë evoluar. Vjeshta e '44-s duket se i gjen në raporte më të afërta e miqësore, çka dëshmohet edhe në këtë letër që sjellim sot. Pasi Mehmet Shehu e falenderon Enver Hoxhën, për kujdesin që ka treguar ndaj familjes së tij, Mehmet Shehu rendit një varg komplimentesh për udhëheqësin, duke e krahasuar me Antonio Gramshin. "Një gjest i këfillë më heq një herë e përgjithmonë ato dyshimet mikro-borgjeze që herë-herë kanë qënë fiksuar në trurin t'im deri në Kongresin e Përmetit kur biseduam bashkë..." i shkruan Shehu, duke i meshuar idesë se i

kanë lënë pas fërkimet që kishin mes tyre deri në majin e 44-ës. Pjesa e fundit e dokumentit siç e thamë i kushtohet luftimeve për çlirimin e Tiranës dhe tregon se me 16 nëntor, kur shkruhej kjo letër forcat partizane po luftonin ende në rrethinat e Tiranës. "Vëndi i juaj është Tirana dhe TIRANËN DO TA ÇLIROJMË ME Ç'DO KUSHT!... Kjo është parulla jonë qysh më datën 11 ora 16 kurse filluam sulmin definitiv", e përfundon letërën e tij Mehmet Shehu.

### LETRA E PLOTË E MEHMET SHEHU

I dashur Enver,  
Telegramin t'ent me të cilin më lajmëronje se Nëna kishte ardhur në Berat e mora tamam në çastin kur po përgatitnim sulmin e përgjithshëm mbi Tiranë. Desha të të kthenja përgjigje me një herë porse veprimet nuk më linin që të gjenja kohë.  
Sot mora një letër nga Fiqreti e cila më thotë se si ti qënke interesuar për Nënë dhe për familjen t'ime. Me një herë diçka më ra ndër mend: Kur isha në fushat e përqëndrimit në Francë, një ditë, në kursin e Historisë së Partisë Komuniste Italiane, Shokët e Partisë na shpjegonin se si themeluesi i Partisë, Antonio Gramsci lidhesh me popullin. Gramsci, si drejtues kryesor i Partisë dhe i Proletariatit, merresh me punët e mëdha të Partisë porse nuk kursehesh që të ulti e të bisedonte me fshatarët e thjeshtë të Sardenjës dhe me puntorët zhlanë t'oficinave të Torinos ose me ndo një plakë q'ishte vranë djali në luftë ose q'i kishin mbetur kalamanjtë pa bukë. Shokët na thoshin se për t'u lidhur me masat, për të qënë njeri i popullit nuk mjafton që të merresh vetëm me çështjet e mëdha dhe kryesore të tyre, porse duhet të lidhesh edhe drejt për së drejti për të parë halllet e tyre që nga afër. Shokët thoshin se Gramsci, mësues i Math i masave, mësonte shumë prej tyre duke u lidhur dhe duke u futur në t'u. Nuk ndjejq kënaqësi për ndihmën materiale që Ti je interesuar që t'i jepet nënës dhe familjes s'ime se sa ndjejq për mua: e para q'Udhëheqësi i Ynë është në rrugën e Udhëheqësit të vërtetë, Gramscit; e dyta se Partija më do. Dhe kjo është ajo që më jep satisfaksionin më të math sepse bindem se Partija e çmon se unë e dua. Një gjest i këfillë më heq një herë e përgjithmonë ato dyshimet mikro-borgjeze që herë-herë kanë qënë fiksuar në trurin t'im deri në Kongresin e Përmetit kur biseduam bashkë.  
Qysh kurse jemi ndarë në Përmet kam reflektuar mjaft. Kam luftuar me vehten t'ime dhe kjo luftë më duket se ka qënë më e ashpër se e gjithë lufta që kam bërë prej at'here e deri tash me armikun. Besoj se më ka vlejtur mjaft dhe të siguroj se më ka vlejtur.  
Këtë jemi duke luftuar ditë e natë për çlirimin e Tiranës, siç e di dhe ti vetë. Tash porsa u ktheva nga Ura e Erzenit ku kanë mbetur 600 Gjermanë të rrethuar nga forcat e onës dhe pak më tej edhe 1200 të tjerë janë duke u asgjësuar. Kemi shpresë se çlirimi i Tiranës është i shpejtë dhe ahëre do jemi në gjendje që të vijmë që këtej për t'u marrë dhe t'u vemë në vendin ku duhet të jini si Qeveri e Parti. Vëndi i juaj është Tirana dhe TIRANËN DO TA ÇLIROJMË ME Ç'DO KUSHT!... Kjo është parulla jonë qysh më datën 11 ora 16 kurse filluam sulmin definitiv.  
Mbesoj se s'është do të shihemi.  
Përhëndetje Shoqërore Ty dhe gjith Shokëve,  
Mehmet  
V.F.L.P.  
16/XI/1944



**Tifozët**

Shqiptarët përpos atyre që jetojnë në Xhenova, do të shkojnë në stadium edhe nga Veriu italian dhe Italia Qendrore, por edhe nga Zvicra, Franca e Gjermania

# Conte me formacionin e dytë ndaj kuqezinjve të De Biasit Shqipëria miqësore luksi e historike përballë Italisë

Në 20:45 në stadiumin e Xhenovas mbi 10 mijë shqiptarë

DYLBER BALLA  
TIRANE

**S**onte në orën 20:45 Shqipëria do të zhvillojë ndeshjen e parë përballë Italisë në historinë e dy vendeve në futboll. Edhe pse është thjeshtë një ndeshje miqësore, interesi të paktën nga pala shqiptare është maksimal, pasi dëshira ka qenë gjithmonë e madhe që të luanim me të kaltrit në kualifikueset e një kampionati Evropian apo Botërori, por fati nuk ka qenë me ne në short. U desh ardhja e trajnerit De Biasi në krye të ekipit kombëtar të futbollit për të lobuar që të realizohej dëshira

e shqiptarëve, të cilët përkrahjen për kombëtaren italiane e kanë të parën, pas asaj kuqezi. Sipas të dhënave të medieve italiane sonte në stadiumin e Xhenovas do të jenë të pranishëm mbi 10 mijë shqiptarë për të ndjekur nga afër ndeshjen. Tifozët shqiptarë, përpos atyre që jetojnë në Xhenova, do të shkojnë në stadium edhe nga Veriu italian dhe Italia Qendrore, por edhe nga Zvicra, Franca e Gjermania. Për të siguruar rendin dhe qetësinë jashtë dhe brenda stadiumit të qytetit të Xhenovas do të jenë të angazhuar rreth 300 policë. Edhe pse Italia e drejtuar nga trajneri Conte nuk do të jetë me formacionin e parë për shkak se të dielën zhvilloi ndeshjen me Kroacinë për Euro

**Shqipëria pritet që të luajë me këtë formacion: Berisha, Cana, Mavraj, Hysaj, Agolli, Kukeli, Xhaka, Vila, Abrashi, Vajushi dhe Balaj**

2016, përjetimi është i njëjtë, pasi përballë do të jetë një formacion me emra cilësorë që kanë spikatur në Seria A. Conte pritet të zbresë në fushë me: Sirigu, De Silvestri, Rossetini, Moretti, Criscito,

Cerci, Aquilani, Poli, Bonaventura, Giovinco, Destro. Ndërsa Antonelli në prag të ndeshjes me Shqipërinë është shprehur se "Shqipëria është një skuadër që duhet ta marrim seriozisht, duke i parë rezultatet e saj të fundit. Ne jemi përgatitur dhe jemi të gatshëm për ta bërë një lojë të mirë. Do të mendohej ta argëtojmë popullin e Xhenovës. Ata kanë zemër të madhe, një forcë dhe dëshirë, të cilën po e demonstrojnë këto ditë" deklaroi Antonelli në konferencën për shtyp. Ndërsa italiani që drejton kombëtaren kuqezi dhe që do të jetë për herë të parë kundër vendit të tij sipas të gjitha të dhënave do t'u besojë këtyre futbollistëve: Berisha, Cana, Mavraj, Hysaj, Agolli, Kukeli, Xhaka, Vila, Abrashi, Vajushi dhe Balaj.

## Duka: De Biasi OK objektiv kualifikimi në Francë 2016

Presidenti i FSHF: Futbollistët që ka ftuar Conte për miqësoren janë të gjithë të zotë

**P**residenti i FSHF, Armand Duka në një intervistë për "Sky Sport" ka folur për ndeshjen e shumë pritur edhe pse miqësore me Italinë, trajnerin De Biasi, por edhe objektivat në lidhje me Euro 2016 dhe dhunën në Beograd më 14 Tetor. "Italia është një skuadër e madhe edhe nëse nuk luajnë ata që ishin ndaj Kroacisë. Nuk e di nëse është më mirë për ne pasi me 25-30 futbollistë që ka ftuar Conte janë të gjithë të zotë. Është e rëndësishme që luajmë për bamirësi por lojtarët tanë përgatiten për një ndeshje të mirë. Shpresoj që të bëjmë një paraqitje të mirë dhe të marrim një rezultat pozitiv" shprehet Duka. Më pas presidenti i FSHF është ndalur te ecuria e trajnerit De Biasi në kombëtaren e Shqipërisë. "Deri tani të gjithë jemi të kënaqur. Nëse bëhet një sondazh në Shqipëri mendoj se De Biasi fiton 90%. Shpresojmë që të jemi bashkë" tha Duka

**Vlerësimi**

"Deri tani të gjithë jemi të kënaqur. Nëse bëhet një sondazh në Shqipëri mendoj se De Biasi fiton 90%. Shpresojmë që të jemi bashkë" tha Duka



Armand Duka

**Trajneri**

## De Biasi: Shqiptarët të dashuruar me Italinë, të jemi të përlulur



De Biasi

Trajneri i ekipit kombëtar të futbollit, De Biasi në një intervistë për "Sky Sport" flet për ndeshjen miqësore përballë Italisë, lidhjen që ekziston mes dy vendeve dhe sigurisht aventurën në kreu të ekipit kuqezi. "Shumë njerëz në Shqipëri bëjnë tifo për Italinë pas kombëtares së tyre. Kundër Italisë do të bëjnë tifo për kombëtaren e tyre. Eksperienca ime në Shqipëri është pozitive, ekipi po rritet dita ditës dhe brenda

një kohe të shkurtër është rinovuar. Jemi duke ndjekur shumë futbollistë me orgjinë shqiptare që luajnë në Europë, pasi kampionati shqiptar do edhe pak kohë për të rritur nivelin" tha ai. Më pas tekniku ndalet te ndeshja miqësore përballë Italisë duke kërkuar përlulësi nga ekipi përballë të kaltërve. "Ne do të bëjmë lojën tonë, do të kërkojmë të jemi inteligjentë, madje të përlulur" thekson ai.

**U-19**

## Europiani Shqipëria e Altin Lalës eliminohet



Kombëtarja U19 e Shqipërisë e ka mbyllur me humbje turin eliminator në kampionatin Evropian. Shqiptarët e udhëhequr nga Altin Lala janë mposhtur nga Uellsit në ndeshjen e tretë eliminator me rezultat 1-2. Takimi është zhvilluar në Portugal. Dy gola e shënuar nga uellsianët janë realizuar nga Thomas ne minutën e 24 dhe 60. Goli i vetëm për kuqezinjtë u shënuar nga Morina në minutën e 74-të. Kështu Shqipëria është eliminuar nga ky turne. Formacioni i Shqipërisë për ndeshjen përballë Uellsit që u zhvillua në Portugal ishte: Elezaj, Toli, Humolli, Kariqi (Ivani), Laci, Rashica (Ndoj), Manaj (Lokaj), Çekiçi, Morina, Stublla, Hoxhalli.





LAJME

nga bota

Greqia,  
"dush" Shkupit  
për shqiptarët

— Shefi i diplomacisë greke, Evangelos Venizellos deklaroi se ekziston problem me emrin e Maqedonisë, por pas tij qëndrojnë edhe probleme të tjera. Ndër problemet për vendin fqinj, ka përmendur edhe marrëdhëniet midis shqiptarëve dhe maqedonasve, demokracinë në vend dhe të drejtat e njeriut, etj. Në një intervistë, ai shtoi se Greqia do të shprehë qëndrimin e saj, si në NATO, ashtu edhe në BE, se ekziston problemi me emrin, por pas tij ekzistojnë edhe problemet e tjera. Venizellos tha se nuk ka ndonjë propozim të ri për emrin nga ndërmjetësi i OKB-së, Metju Nimic. Ministri gjithashtu ka fajësuar Shkupin se nuk po bën hapa vendimtarë lidhur me gjetjen e një zgjidhje për emrin.

Ponta humb  
garën për  
president

— Favoriti kryesor për zgjedhjet presidenciale në Rumani, kryeministri Victor Ponta, ka pësuar një humbje shokuese në zgjedhjet e balotazhit, të mbajtura ditën e diel, pas shpalljes së rezultatit që nxori fitues kandidatin Klaus Iohannis, i cili pati një kthim të habitshëm kryesues. Në raundin e parë të zgjedhjeve Ponta kryesonte zgjedhjet, ndërsa këtë raund pati një kthesë. Ponta i telefonoi kundërshtarit për ta uruar. Ai përjashtoi dorëheqjen nga posti kryeministrotor e tha se socialdemokratët do të qëndrojnë në pushtet deri në zgjedhjet e 2016.

BE, gati  
sanksione për  
Rusinë

— Ministrat e Jashtëm të Bashkimit Europian po diskutojnë mbi një raund të ri sanksionesh ndaj Rusisë, pasi rebelët pro-Moskës vranë të paktën 9 ukrainas gjatë përleshjeve të ripërtëritura në zonat lindore. Nga sa pohoi shefja e Politikës së Jashtme të BE-së, Federica Mogherini, në axhendën e takimit do të jetë edhe ndihma për reformimin e Ukrainës. Sipas saj, masat kundër Rusisë nuk do të funksionojnë, nëse nuk ecet përpara me reformat në vendin e trazuar prej Moskës, siç pretendon Perëndimi. Mogherini thotë se blloku evropian duhet të nisë një mision asistence për autoritetet ukrainase, i cili të ndihmojë në ristrukturimin e sigursisë civile të vendit.

**RREZE DIELLI**

**PREZENTIMI**

Orë 7.30 - 11.00  
në televizionin

**A1 REPORT!**

**ME ZNJ. TEFTA**  
me recetat e gatimit  
më të veçanta

**NEIDA**  
ë ftuarit më special

Alba Malltezi - Drejtore e Përgjithshme e Free and Fair Media Group ; Aurel Pepa - Zv/kryeredaktor  
Genc Kondi - Administrator i Përgjithshëm & Ekonomi ; Admirina Peçi - Kryeredaktore e "Rilindasi" ; Politika: Ervin Koçi ; Aktualitet: Elton Qyno ; Sociale: Sonila Isaku ;  
Kulturë: Dhurata Hamzai ; Sporti: Dylber Balla ; Design: Altin Aliaj, Erjon Ymeri ; Website: Greta Malaj ; Shpërndarja: Spiro Meshini tel: +35569608847

Departamenti i Marketingut:  
Vera Përleka  
Cel: +355696060419  
marketing@shqiptarja.com

Redaksia: Rruga: "Dervish Hima" tre kullat, kulla e dytë-Tiranë. E-mail: redaksia@shqiptarja.com - Website: www.shqiptarja.com - Mobile: +355696060421 - Shtypur në shtypshkronjën: KLASS shpk, Rruga 5 Maji, Tiranë